



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 143, shtator 2015

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

PROFILE DHE ... MË SHUMË

Editorial nga Luigj SHYTI

Në kohën e sotme zhvillimi po ecën më vrull, shoqëria po përparon, por krahas kësaj po ndodhë edhe fenomeni i polarizimit, i cili po "vrapon". Shumica e shoqërisë po e pëson nga ky fenomen, shtohet numri i atyre që përfitojnë pak nga ky zhvillim dhe rritet përfitimi i atyre që kanë më shumë. Jo radhë dëgjohej copëza bisedash, veçanërisht gjatë fushatave elektorale të gjitha ringjeve, si "më mbështesin punëtorët që kamë në punë, sepse unë i mbaj me bukë", ose padroni i bërtet punëtorit "kujdes se ta heq bukën", pa përmendur shumë, të cilët, janë të pa siguruar, dhe mund të aksidentohen, madje të mbeten edhe të gjymtuar dhe nuk mund të përfitojnë ndonjë ndihmë zyrtare nga shteti. Të tjerët u drejtohen lëmshave për të mbijetuar. Duhet të jenë e qartë për këdo se nuk ka varfëri ka pasuri, por nga se të pasurit janë të pangopshëm.

NJË JETË NË SHËRBBIM TË ARSIMIT, ME SHUMË DEVOTSHMËRI

2

Në arritjet e pamohueshme në sektorin e arsimit në Dukagjin gjatë disa dekadave më parë në masivizimin, konsolidimin e rritjen cilësore të shkollës, kontribut kryesor kanë dhënë vetë mësuesit dukagjinasi, ku padyshim një ndër kryesorët ka qenë, Lazër Fusha, ne detyra të ndryshme: drejtues shkollash dhe mësimdhënës, sot në pension.



DOM LORO CAKA I LAVDËRUAR DHE I SHUMËPËRFLORUR ME EPITETE NGA MË TË ZYMTAT

4

Sa qita kushtrimin në Pukë e Dukagjin ma bahen fotosat e maleve tona si blea kur del prej zgjojet

Një figurë e njohur e klerit katolik dhe jetës politike shqiptare në çerëkun e parë të shekullit njëzetë. Një personalitet kompleks, i lavdëruar, por edhe shumë i përfolur me epitete nga më të zymtat. Te figura e Dom Loro Cakës nuk kishte një cak të qartë ndarës mes klerikut dhe politikantit, demokratit dhe revolucionarit, pacifistit dhe rebelit, të filoitalianit dhe filojugosllavit, nacionalistit edhe tradhtarit (siç e akuzojnë me mlllef armiq të tij Ahmetisët), engjëllit apo shejtanit (ku nuk kanë nguruar ta quajnë kështu as kolegët klerik të një besimi).



MENDIME, KOMENTE DHE KONSIDERATA PËR VËLLIMIN POETIK "LAMTUMIRË MOS THUJ", TË L. SHYTIT

6




VDIQ MARK KRASNIQI PISHTAR I MENDIMIT SHQIPTAR

Me vdekjen e Mark Krasniqit u shua një pishtar i mendimit shqiptar.

Letrat shqipe humbën një ikonë urtësie, mirësie dhe devocioni. Etnografia jonë humbi patriarkun flokëbardhë, gjeografia humbi komentarin autentik, publicistika, humbi stilistin shigjetues. Poezia humbi një vegim rrezellitës. Bota trëndafilore humbi poetin e ledhatimeve dhe gicilimeve të magjishme femnore. Politika humbi idealistin me profil perëndimor. Jeta Mark Krasniqit është refren marshesh të zjarra atdhetare.

Me aq pasion sa donte Kosovën, Shqipërinë, natyrën dhe visaret tona kombëtare, donte lirinë e munguar, çmonte demokracinë dhe progresin, së cilës ju përkushtua me mish e me shpirt. Emri i Mark Krasniqit u nde jo vetëm në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, por edhe në Ballkan e me më gjerë. Emri i qëndron në radhën mendjeve më të ndritura të shkencore, letrare dhe politike të botes shqiptare. Nikaj - Merturi që i fali genin, Peja që e lindi, Kosova që fisnikëroi, Shqipëria që pati birë kanë drejtë të ndihen krenar për këtë burrë të madh të atdheut. Baca Mark u shua fizikisht por shëmbëllimi i veprës së tij shkëlqen si dielli në majat qiell-prekë mendimit intelektual shqiptarë



11

BANORËT E FASHTIT DERRAJ, NË DOMËN KANE ORIGINËN NGA FSHATI LOTAJ – SHALË

7

Është një fshat i vogël, poshtë Qafës së Thanës, midis Domnit dhe Shakotës, sipër Rrosekut, që quhet Derraj. Më shtyri interesi, si edhe për shumë fshatra dhe zona të tjera, që ka lidhje me shpërndarjen e banorëve të fshatit Lotaj të Shalës në shekuj, siç është rasti i Jubanit, Dajçit të Bregut të Bunës, familjen Koliqi në Shkodër, Lotajt në Velikë, në Ulqin buzë lumit Buna, Dinoshë, Nju Jork, Lotajt në Abat të Shalës, Lekaj...

SHABAN GJEKAJ, BILBILI I KËNGËS POPULLORE ULQINAKE

8

"Tujë iu ngjit Bunës përpjetë" është një ndër këngët më të njohura që Shaban Gjekaj me interpretimin e tij brilant e ka përjetësuar në fondin e artë të këngës popullore qytetare. Kjo këngë është ilustrimi më i mirë për të shpjeguar lidhjet e vjetra kulturore e zakonore të dy qyteteve, Ulqinit e Shkodrës që natyrshëm banorët e këtyre anëve i quajnë vëlla e motër. Buna, ky lumë legjendar, i qetë e i lundrueshëm që buron në zemër të Shkodrës ka përkundur në ujërat e veta, jo vetëm varka,

NJË JETË NË SHËRBBIM TË ARSIMIT, ME SHUME DEVOTSHMERI

Në arritjet e pamohueshme në sektorin e arsimit në Dukagjin gjatë disa dekadave më parë në masivizimin, konsolidimin e rritjen cilësore të shkollës, kontribut kryesor kanë dhënë vetë mësuesit dukagjinasi, ku padyshim një ndër kryesorët ka qenë, Lazër Fusha, në detyrë të ndryshme: drejtues shkollash dhe mësimdhënës, sot në pension.

U lind në vitin 1942 në Breglumi të Shalës nga një familje me tradita patriotike, bujare, mikpritëse e bukëdhënë. Mësimet e para fillore e 7 vjeçare i mori në vendlindje, pastaj përfundoi shkollën e mesme pedagogjike “Shejnaze Juka” në Shkodër me rezultate shumë të mira. Mbasi ushtroj për disa vite profesionin e mësuesit dhe kreu shërbimin ushtarak, i etur për dije dhe nga dëshira me qenë sa më i aftë për të kryer detyrën e shenjtë të mësuesit, vazhdoi dhe përfundoi me rezultate të shkëlqyera edhe Institutin e lartë pedagogjik të Shkodrës, dega histori – gjeografi-fizkulturë. Kudo që shërbeu si drejtues dhe mësimdhënës në shumë shkolla të Shoshit e Shalës, në Palaj, Ndreja, Lotaj, Breg-lumi, Abat, Gimaj, Ndërlis e Thethë, është shquar dhe bërë diferencën si organizator e drejtues shumë i mirë, korrekt në punë e disiplinë shumë të lartë në të tërë kompleksitetin e saj, përgatitje të lartë shkencore e pedagogjike, aplikues i metodave shumë frutdhënëse për mësimdhënie i cili orë së mësimi i jepte jetë

e gjallëri duke pas një gjuhë të veçantë komunikimi me nxënësit. Ata i konsideronte objekt e subjekt i mësimi. E dëgjoni dhe i dëgjonte duke krijuar marrëdhënie të shëndosha mësues – nxënës si askush tjetër larg çdo pedantizmi. Me punën e tij jua lehtësonte nxënësve rrugën e të nxëniti. Të gjitha këto bënin që rezultatet në shkollat që drejtonte dhe në lëndët që jepte mësim të jenë nga më të lartat. Ishte model në kryerjen e çdo detyrë që i ngarkohej duke u bërë shembull për kolegët e tjerë, ku edhe ndihmesa e tij, sidomos për mësuesit e rinjë, kurrë nuk ka munguar. Ishte ndër të rrallët që të gjithë nxënësit i konsideronte të barabartë dhe të gjitha lëndëve u jepte të njëjten rëndësi e vlerësim. Pra për Të nuk kishte lëndë të “para” e të “dyta”. Gjithmonë ka qenë tip studiues. Ndihej në çdo kohë me të rejat e shkencës dhe pedagogjisë, të cilat jua transmetonte nxënësve në procesin mësimor, duke ndihmuar direkt në përvetësimin sa më cilësor e të qëndrueshme të dijeve nga ana e nxënësve të cilëve u jepte mësim. Edhe sot biblioteka e tij është ndër më të pasurat e ndonjë punonjësi arsimi, e cila zmadhohet çdo vit. Sa i dashur dhe i afrueshëm ishte me kolegët e nxënësit, aq i ashpër e kritik ishte ndaj çdo mangësie që ishte në punën e sjelljen e

tyre. Krijonte një marrëdhënie model mësues – prind, sepse për vetë natyrën dashamirëse, gjente në çdo kohë një gjuhë të përbashkët me komunitetin kudo ku ka punuar duke tërhequr mendimin dhe ndi-



hmesën e tyre për zgjidhjen e problemeve të shkollës. Edhe sot kudo të flasim me shumë respekt për z. Lazër. Përveç detyrave shtetërore, Ai ishte shumë korrekt, aktiv dhe i papërtueshëm edhe në detyrat shoqërore sidomos në ndihmë të kuadrove të paafte që regjimi i kohës i dërgonte për të drejtuar në Dukagjin. Kjo edhe falë një shkrimi sipas të gjitha rregullave drejtshkrimore dhe aftësisë për të

koncentruar e përpunuar mendimet e të tjerëve duke dhënë shumë edhe nga dijet e veta. Ai nuk ishte i njëanshëm, thjeshtë mësimdhënës, si shumë të tjerë. Ishte dhe është nga ata që, siç thotë populli “Çka i sheh syri ja bën dora”, mjeshtër i vërtetë në punimet me dru, me gurë e hekur. Sigurisht që kurrë në kurriz të punës si mësues. E shfrytëzonte maksimalisht kohën e lirë, duke mos e lënë që ajo të shkojë kot. Këtë e tregoj kudo ku banoj dhe banoj familjarisht sidomos në Breg – lumi e së fundi në periferi të Tiranës duke ndërtuar vendstrehimet e tij si një arkitekt i vërtetë. U njoh me bashkëshorte, Lenën nga Shëngjergji i Mërturit, edhe Ajo mësuese matematike, bashkë krijuan një familje shembullore dhe të emancipuar. Lindën dhe rritën 3 djem të mrekullueshëm, Astritin, Bledarin e Florianin. I edukuan dhe shkolluan si më të mirët dhe sot kanë formuar familjet e tyre në Greqi e Itali. Lazeri është bërë gjysh me 7 nipa e mbesa. Si gjithë të tjerët, edhe Lazeri u përfshi në ndërrimin e sistemit e ardhjen e pluralizmit. Sigurisht që nuk e priti me sportivitet, i nisur jo nga nostalgjia, por sepse, si shumë të tjerëve, nuk i pëlqej mënyra e ardhjes së demokracisë që sipas tij nuk erdhi asnjëherë ajo si duhet. Nuk ishte për atë që gjithçka të shkatërrohet e të fil-

lohet nga zeroja gjoja në emër të antikomunizmit. Nuk ishte dakord, përkundrazi i përjetonte me dhimbje shumë plagë të reja që sistemi i ri i krijoj, gjakmarrja, droga, prostitucioni, trafiket e ndryshme, lëvizjet e pakontrolluara etj. Edhe Ky u përfshi nga lëvizjet demografike dhe disa vite më parë u vendos familjarisht në periferi të Tiranës duke ju përshtat vendbanimit të ri, duke mos e lënë për asnjë çast punën as studimin.

Temi një të vërtetë kur shprehim bindjen se Lazër Fusha është një ndër intelektualët e shquar dukagjinasi me një formim të gjithanshëm, vital e me vullnet të hekurt për të kryer çdo detyrë që i ngarkohet apo për të çuar deri në fund çdo iniciativë që merr duke qenë një enciklopedi e gjallë dhe i aftë për të komunikuar me njerëz të moshave e profesioneve të ndryshme duke i dhënë secilit atë që meriton. Ka aftësi me ju përshtat çdo mjedisi sepse përveç formimit tek Ai janë harmonizuar më së miri vetitë e virtytet më të mira të vendlindjes me edukatën qytetare i cili nuk ka pra së përpjekuri për ti shtuar dijet për të qenë sa më bashkëkohorë.

Do të ishte mirësi e madhe që sot të kishim sa më shumë mësues dukagjinasi e jo vetëm, siç ishte Lazër Fusha, të përkushtuar për ta justifikuar misionin e shenjtë të mësimdhënisit.

Kohët e fundit, z. Lazër ka pasca problem me shëndetin por jemi të bindur se me vullnetin e tij të hekurt dhe vendosmërinë që e karakterizon do të triumfojë mbi ligësinë dhe së shpejti do të kthehet midis nesh sepse kemi përsëri nevojë për Të.

PRELË SHYTANI

MARTIN CAMAJ – YNI APO I MËRGATËS?

PËR 90-VJETORIN E DITËLINDJES SË MARTIN CAMAJT

Sot, më 21 korrik 2015, mbushen 90 vjet nga lindja e poetit, prozatorit dhe albanologut Martin Camaj.

Poezia e tij mbase më e cituar është “Vendit tem”. Tash, me rastin e 90-vjetorit të lindjes së tij, dhe pasi ai dëshmoi me veprën letrare dhe shkencore që Shqipëria ishte vendi i tij, mund të shtrohet pyetja nëse Shqipëria e ka bërë Martin Camajn shkrimtar të vendit të tij, d.m.th. nëse Camaj në vendin e vet e ka gjetur vendin e duhur pas një gjysmëshekulli të heshtjes totale për të, ku ai nuk u përmend as për të keq si “tradhtar” e “reaksonar” (si rasti i sulmit të Kadaresë ndaj Fishtës sipas motos “më mirë

të përmendet për të keq sesa të mos përmendet dot”) dhe pas një çerekshekulli të pluralizmit shqiptar.

Postmortem në Shqipëri janë bërë përpjekje jo të pakta për të bërë të njohur e për të vlerësuar Martin Camajn dhe veprën e tij. Më 1996-n, Ardian Klosi botoi një pjesë të madhe të veprës letrare të Camajt; në fillim të viteve ’90, botuesi “Camaj-Pipa” në Shkodër botoi gjithashtu një pjesë të veprës letrare camajane. Më 2010-n, shtëpia botuese “Onufri” botoi veprën e plotë letrare të Camajt. Poezi të tij gjenden në disa antologji. Po ashtu, më 2010-n, ish-presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, nderoi Camajn me titullin “Nder

i Kombit”. Më 2002-shin, Martin Camajt iu akordua çmimi kombëtar për letërsi “Penda e Artë”. Për veprën letrare camajane janë shkruar libra (Anton N. Berisha, Koçi Petriti, Ymer Çiraku, Primo Shllaku, Behar Gjoka), punime master dhe disertacione. Vjetëve të fundit dolën libra seriozë studimorë nga Hasan Sinani (2011) dhe Albana Alia (2014). Më 2013-n u xhirua dhe u shfaq dokumentari biografik i gazetares Tefta Radi “Martin Camaj i papërsëritshëm”.

Prapëseprapë, duket sikur Martin Camaj ende nuk e ka vendin e duhur në vetëdijen kolektive shqiptare. Këto ditë, Akademia e Shkencave e përkujtoi me një simpozium përvje-

torin e 85 të vdekjes së poetit atdhetar Çajupi dhe nuk ia kushton vëmendje poetit të madh të poezisë moderne shqiptare, Martin Camaj. Ministria e Kulturës preferon të merret jo me përvjetorin e Camajt, por me mbrojtjen e monumenteve të kulturës për “turizmin kulturor”, me ekspozita artistësh etj. Një lidhje e shkrimtarëve për të qenë, fatkeqësisht, nuk ekziston. Shtypi hesht sa institucionet e kulturës. Kur bëhet fjalë për poetët e mëdhenj shqiptarë të kohës sonë, ende flitet dhe shkruhet për Dritëro Agollin dhe Ismail Kadarenë. Tash së voni hasa në një listë të vogël shkrimtarësh që “ne i kemi nxjerrë” në kohën e diktaturës, ku u për-

mendën autorë si Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Dhimitër Shuteriqi, Xhevahir Spahiu e shkrimtarë të tjerë të njohur të kohës. Për fat të mirë, lista mbaroi me Frederik Rreshpjen, të cilin më së shumti begenisin ta “harrojnë”. Simptomatike ishte mungesa e emrit të Kasëm Trebeshinës që e injorjnë për shkaqe jashtë letrare, si dhe mosprania e Martin Camajt – siç duket po ashtu për shkaqe jolettrare.

Mosprania e poetit dhe prozatorit Camaj në vetëdijen e përgjithshme duket se në radhë të parë nuk është se “Camaj është i vështirë”, por se ai konsiderohet ende si shkrimtar “i diasporës”, “i mërgatës”, “i ekzil-it”. (vijon në faqen 11)

PROFILE DHE ... MË SHUMË

Editorial nga Luigj SHYTI

Në kohën e sotme zhvillimi po ecën më vrull, shoqëria po përparon, por krahas kësaj po ndodhë edhe fenomeni i polarizimit, i cili po “vrapon”. Shumica e shoqërisë po e pëson nga ky fenomen, shtohet numri i atyre që përfitojnë pak nga ky zhvillim dhe rritet përfitimi i atyre që kanë më shumë. Jo radhë dëgjohen copëza bisedash, veçanërisht gjatë fushatave elektorale të gjitha ringjeve, si “më mbështesin punëtorët që kamë në punë, sepse unë i mbaj me bukë”, ose padroni i bërtet punëtorit “kujdes se ta heq bukën”, pa përmendur shumë, të cilët, janë të pa siguruar, dhe mund të aksidentohen, madje të mbeten edhe të gjymtuar dhe nuk mund të përfitojnë ndonjë ndihmë zyrtare nga shteti, por vetëm u drejtohen lëmshave për të mbijetuar. Duhet të jenë e qartë për këdo se nuk ka varfëri se nuk ka pasuri, por nga se të pasurit janë të pangopshëm. Punëtorët nuk mund të jenë miq me padronin në kushtet kur punojnë, shumë shpesh, të paktën 8 orë, por ka edhe më shumë, dhe marrin 500 lekë në ditë, dhe këto pa sigurime shëndetësore. Duhet të jenë e qartë për këdo se nuk ka varfëri se nuk ka pasuri, por nga se të pasurit janë të pangopshëm. E vetmja mënyrë, e vetmja armë, për të rritur vlerat e punës së tyre, për të përfituar më shumë në raport me punën që bëjnë, është vota. Ndonjëri mund të mendojë se tash nuk është koha për të menduar për votat e votimet, por gabohen, sepse për të menduar për votat dhe votimet është gjithnjë koha në demokraci. Vota në demokraci mund të shkaktojë tërmet edhe në marrëdhëniet punëmar-rës-punëdhënës. Vota në drejtimin e duhur krijon mundësinë e përparimit më të shpejtë të shoqërisë dhe në nivel më të gjerë, ulë nivelin e polarizimit, shoqëria njerëzore bëhet më bashkëpunuese e bashkëvepruese, më tolerante.

Populli duhet të hapë sytë më shumë, sa më shumë rritet diferenca në polarizim, të bëhet më i ndërgjegjshëm për të ardhmen e tij dhe brezave që vinë. Kur populli është indiferent, nuk përpiket të dijë dhe të reagojë, nuk përpiket të kuptojë se çfarë po ndodhë çon akoma më shumë në polarizimin e shoqërisë, pra varfërohet shumica dhe pasurohet pakica.

Në shoqërinë njerëzore bëjnë pjesë edhe intelektualët, inteligjentët, militantët, mitingashët, ndodhen atje ku zhvillohen mbledhje, mitingje, madje masive.

Këta krejt mire mund të jenë në të njëjtën parti, në të njëjtin miting, në të njëjtin front, por përfitimet mund dhe duhet të jenë të ndryshme.

Intelektuali merr pjesë në mbledhje, tubime apo mitingje ,

shikon dhe dëgjon me vëmendje, duartroket fuqishëm, por edhe tund kokën në shenjë mosmiratimi. Ai nuk çirret, nuk shanë, nuk hidhet e përdridhet, mund të kenë edhe një flamurë në dorë, por e mban bukur, madje edhe e ruan të mos grisë e keqtrajtojë. Mundë të jenë edhe militant, por i vendosur në mënyrë të arsyetuar në pikëpamjet e tij, në atë formacion që është pjesëtar, ose simpatizant.

Për intelektualin mund të rreshtohen shumë cilësi, por disa prej tyre janë: Është i shkolluar.

Punon mirë, kundërshton servilizmin, kërkon dhe jep drejtësi. Edhe kur arrin nivele drejtimi njohuritë e tij i vendosë në shërbim të tjerëve të komunitetit, (natyrisht edhe ai duhet të ushqehet e të jetojë), është bashkëpunues edhe me kundërshtarin sa të jenë e mundur, nuk përdorë mikun për të arritur qëllimin, mbështetet në ligj për organizimin dhe drejtimin e punës, afron pranë vetës njërës të ditur, është me shpirt idealist, menaxhon, përdorë përemrin “ne” në shumicën e rasteve, përdorë shprehje “duhet ta bëjmë”, pa shkelur ligjin i bën vartësit që të vinë me qejf në punë, është fytyrëçelur, i qeshur, me vartësit edhe kur ka mosrealizime, kërkon që ti gjejë vartësit duke punuar mirë dhe i përgëzon, pa neglizhuar të metat prodhon ide, i shërben shoqërisë.

Inteligjenti është pjesë e shoqërisë, mund ose është i shkolluar , por shkolla që ka marrë nuk ka nivelin që të përballojë kërkesat e tregut, sepse e ka marrë me ndërhyrje, prandaj dhe kërkon shokun “miku”, është midis nesh, është i pranishëm kudo, madje tregohet edhe aktiv, por shpesh merr natyrën e mitingashit, sepse e nxitin ndjenjat që i vlojnë përbrenda. Punon për tu dukur, i bën shumë reklamë punës së vet. Inteligjenti, njohuritë e tij i përdorë me kujdes në shërbim të vetes, për përfitime personale. Kur arrin në role drejtuesi ndryshon shumë qëndrimin ndaj kolegëve të tij të mëparshëm, është hakmarrës me kundërshtarin, kërkon ta gjejë kundërshtarin në gabim dhe ta qortojë, kërkon dhe përdorë mikun për të arritur qëllimin, afron pranë vetës njërës të pa ditur që ti përdorë si shërbyes, komandon, urdhëron, përdorë kudo përemrin “unë”, urdhëron “do ta bësh”, është me shpirt materialist; me punën e tij, vartësve të tij u duket vendi i punës një vend i vështirë, vend tmerri, është i vrazhdët gjithnjë me vartësit, ndërsa me eprorët muskuli i ngërdheshjes (të qeshurës) qëndron i tendosur deri te veshi, kërkon që ti shërbehet, prodhon “pse” me shumicë, për çdo gjë.

Mitingashi ka profil interesant. Mbase shumica e shoqërisë mund të përfshihet në mitingje, por mitin-

gashi është shumë i dhënë pas tyre. Shpesh është inteligjent, mbase edhe i shkolluar. Shikon dhe kupton se nga shkon rrjedha, dhe vihet në atë drejtim, madje “vrapon”, pavarësisht rezultatit të pritshëm, apo përvojës nga e kaluara. Ai ndjek mitingjet ku janë e ku s’janë, përpiket të afrohet tribunës, folësit kryesor, kryetarit, titullarit, të madhit. Mitingashi bërtet, madje çirret, hidhet e përdridhet, nuk do t’ia dijë çfarë flitet para mikrofonit, por vetëm ngjiret duke ulëritur për kryetarin, për deputetin, titullarin, tund flamurin deri sa e grisë, shanë me të parë dhe me mbarmë kundërshtarin, nuk ka rëndësi për të nëse e dëgjon dhe e vlerëson ndokush, atij i mjafton të dëgjojë veten e tij, zërin që nxjerr nga gojë e vet, paçka se në shumicën e rasteve të tilla nuk arin deri në veshin e tij ajo që nxjerr goja e vet. Përdorë fjalë që as vetë fjalori , nga më i madhi, nuk i përmban, i mungon kultura, ka vetëm zërin, forcën fizike dhe mikun. Po ndodh, fatkeqësisht, që edhe mund të jenë të paguar për pjesëmarrje, britma, çjerrje, tundje flamurësh, apo sharje.

Ata që janë në pushtet i kanë zyrat plot, shumë në mos shumica për të pritura një dromcë (thërrime) një copë, një karrige. Kjo është, në një farë masë normale, sepse gjithkush përpiket që të ngrihet sa më lartë, të përfitojë sa më shumë, por kush e zë atë, kush përfiton, ai që e meriton apo ai që nuk e meriton, intelektual apo inteligjenti, ai që arsyeton apo ai që bërtet, që çirret apo kërcënon, “i miri” apo “i forti”. Intelektuali konsiderohet i mirë, inteligjenti konsiderohet i fortë, pra kush fiton, i miri apo i forti? Në një shumicë të frikshme fiton “i forti”. Ai, pastaj mbledh rreth vetes ata që i interesojnë, që kanë “punuar” për të, që kanë marrë premtimet, pavarësisht vlerave dhe aftësive intelektuale që bartin, pavarësisht nëse kanë aftësi të prodhojnë “ide” apo të prodhojnë “pse”. Shoqëria njerëzore ka nevojë për ide dhe mendime prodhimtare për të ardhmen.

Vota u kërkohet por, më me ngulm i kërkohet shtresës që është më në nevojë, sepse atyre edhe mund tu merret me më pak lodhje ose, çfarë është edhe më e keqja, mund të mashtrohen me pak vlera monetare apo materiale. Ai që shet votën nuk ka më pushtet mbi të, nuk ka të drejtë që të kërkojë se çfarë u bë me votën e tij. Pas votimeve, shumë shpesh, nuk ka më interes për votuesit. Vota u kërkohet të gjithëve, dhe tashmë dihet se shumica është popullsia nën mesataren e nivelit të jetesës, madje edhe në nivelin e varfërisë, e kjo votë shkon te të kamurit për të qëndruar apo për të hipur në karrige. Pra shumica, dhe këtu nuk kemi parasysh shumicën politikë,

por shumicën për nga niveli ekonomik, i jep votën pakicës që të qëndroje ose të hipë në pushtet, rrjedhimisht pakica udhëheqë, drejton, shumicën, dikush voton dhe dikush votohet, pavarësisht nga krahët politik, gjithnjë ata me nivel të ultë ekonomik i japin votën atyre me nivel të lartë ekonomik.

Pas votimeve elementët e shoqërisë, të cilët mbështesin partinë e tyre, duhet të jenë, në vende të ndryshme. Intelektualit i takon drejtimi, karrigia, me qëllim që të vejë njohuritë e tij në shërbim të komunitetit për përmirësimin e jetës së tyre, që të përmirësohet edhe jeta e inteligjentit, mitingashit, votuesit, të gjithëve. Mitingashit, inteligjentit, mund ti gjendet vendi i përshtatshëm, por asnjë herë të mos zeje vendin e intelektualit. Interesat e kësaj kategoria janë të ngushta, personale, përfituese. Ky grup jo radhe mendohet si të fortë, trima, të zotët.

Zoti i fal njerëzit të barabartë, atëherë pse disa, dikush, duhet të qeverisë tërë jetën dhe disa të qeverisen tërë jetën. Përvoja botërore ka treguar se edhe ato shtresa që konsiderohen të ulëta, kanë lindur njerëz të mëdhenj. Dhe shtresa të ulëta në pikëpamjen ekonomike janë shumica e popullsisë, jo vetëm tek ne por në tërë botë. Atëherë a qeveriset një popull, një komb, nga shumica apo jo? Shtresat e larta ekonomike flasin, përpiken dhe bëjnë ligje për vete dhe për ata që janë poshtë këtyre niveleve. Natyrisht ligjet në dëm të vetes nuk kalojnë ose kalojnë shumë radhë. Ai që është në kushte të mira, që është “në kalë”, nuk mund tu besojë atyre që janë nën nivelet e tyre, që janë në këmbë. Ka ndodhur shpesh që kalorësi t’i thotë këmbësorit “ec më shpejt”, “pse ecën ngadalë”. Sa përfaqësohen në institucionet e politikës, ekzekutivit, qeverisjes, legjislacionit, administrative, gjyqësorit, ata që janë shumica, pra ata që janë nën ose rreth mesatares ekonomike. Vendet këmbëhen midis krahëve politik, popullsisë me nivele të ultë ekonomik mbete në të njëjtin vend, poshtë me njërën, poshtë me tjetrën. Natyrisht që nuk ta falë kush pushtetin, karrigen, vendin e punës, e për këtë duhet të lëvizin shtresat e popullsisë, të kërkojnë, të ndërhyjnë me këmbëngulje për ndryshimin dhe përmirësimin ekonomik dhe politike. Nuk bëhet me lutje, me përkëdhelje, por me votë të fuqishme dhe masive. Kjo mund dhe duhet të ndryshojnë rrjedhën e ngjarjeve. Nuk janë të paafte të gjithë, madje ka edhe shumë të aftë. Flitet për familje të mëdha dhe bëmat e tyre. Po ka të tilla dhe duhet respektuar, por a mund të mbetemi gjithmonë vetëm te këto. Po pjesa tjetër e popullsie kur do të bëhet “familje e madhe”, a do të

bëhen ndonjë herë. Edhe kjo nuk arrihet me lutje, por do përpjekje të fuqishme nga masa e komunitetit, nga individët, veprime , këto që, duhen mbështetur për të mirën e shoqërisë. Fenomeni “Obama” duhet parë kujdesshëm me syrin pozitiv, por duket se vendet janë zënë dhe këmbëhen, pavarësisht grindjeve mediatike, zënkave, sharjeve apo shpifjeve, në rotacionin periodik, pa u bërë vend të tjerëve. Tu bësh vend të tjerëve nuk është dëshirë por është detyrë. Me dëshirë apo pa dëshirë, ata që janë qepur pas karriges dhe kanë dhënë çfarë ka pasur për të dhënë, duhet ta lirojnë atë. Vota e nisur dhe e aritur atje ku duhet bën ndryshimin. Brezi i ri është më i zhvilluar dhe i përparuar gjithmonë, e ai duhet të marrë përsipër detyrën e zhvillimit dhe çuarjes përpara të shoqërisë. Në qoftë se këta nuk kanë aftësinë për të drejtuar, për të menaxhuar në një sektor, pse jo edhe për të qenë në sferat e larta të pushtetit dhe shtetit, atëherë pse tregohet aq shumë kujdes për tu kërkuar votën me të gjitha mënyrat, pse fliten aq fjalë të bukura, deri në mallëngjim, pse ngrihen aq lart gjatë fushatave zgjedhore. N.q.s. ky, populli, është kaq i mirë, dhe, vërtetë është, pse nuk i bëhet vend në sofrën politike, në tavolina dhe kuvende.

Po ndodhë rëndomtë që populli i thjeshtë dhe në nivele të ulëta ekonomike, pse jo edhe nga ana kulturore, duke u mburrur me çfarë kanë bërë të tjerët përpara tyre, brezat e kaluar, me aq sa kishin mundësi, me rregullat e vendosura në marrëdhëniet shoqërore të copëtuara, sipas krahinave, për një farë vetëqeverisjeje, historikisht është, dhe, gati mbetet tragjik, pa përfaqësim për të nga të tjtë. Kaq shumë është ngulur fara e urrejtjes dhe po kaq shumë e urrejnë ata që e shikojnë nga lart, apo nga larg dhe, përsëri, me një shumicë të frikshme vazhdon t’u besojë, symbyllazi në ndjekje të pronarëve të riinj apo trashëgimtarëve të tyre, në ndjekje të specialistëve të përpunimit psikologjik, duke i bërë shpëllarje trurit të atyre që votojnë, në dobi të atyre që votohen, sa në një ekran në tjetrin, sa në një gazetë në tjetrën, sa në një radio në tjetrën, të cilat, falë zhvillimeve elektronike kanë mbirë si kërpudhat, pa çka se po mbytin edhe rrjetet sociale, edhe rrjetin telefonik. Komuniteti, populli, që nuk hell poshtë më neveri iluzionet e përfitimeve individuale të rastit, që nuk merr mbi supet e veta boshtin e jetës, ndonëse të drobitura dhe gati të thyera nga pesha e rëndë, e që këto iluzione janë të zbrazëta, boshe që nuk të çojnë asgjëkund, e këtë bosht, me synim drejt përparimit të shoqërisë, ose të paktën, të shumicës prej tyre t’ua dorëzojë bijve dhe bijave që mendojnë për të ardhmen, për përparimin e zhvillimin e komunitetit, popullit, kështu do të mbetet, satirik, komik, dramatik, pse jo edhe tragjik.

DOM LORO CAKA I LAVDËRUAR DHE I SHUMËPËRFOLOUR ME EPITETE NGA MË TË ZYMTAT

Sa qita kushtrimin në Pukë e Dukagjin ma bahen fotosat e maleve tona si bleta kur del prej zgjojet

Një figurë e njohur e klerit katolik dhe jetës politike shqiptare në çerekun e parë të shekullit njëzetë. Një personalitet kompleks, i lavdëruar, por edhe shumë i përfolur me epitete nga më të zymtat. Te figura e Dom Loro Cakës nuk kishte një cak të qartë ndarës mes klerikut dhe politikanit, demokratit dhe revolucionarit, pacifistit dhe rebelit, të filoitalianit dhe filojugosllavit, nacionalistit edhe tradhtarit (*siç e akuzojnë me mllef armiqët e tij Ahmetisët*), engjëllit apo shejtanit(*ku nuk kanë nguruar ta quajnë kështu as kolegët klerik të një besimi*).

FËMIJËRIA DHE AKTIVITETI PATRIOTIK

Dom Loro Caka lindi në fshatin Spathar të Shkodrës, me 10 gusht 1865. Shkollën fillore e kreu në Seminarin Papnuer në Shkodër, kurse shkollën e mesme dhe të lartë në Zagreb. Më pas studion edhe në Vjen për Filozofi. Shugurohet meshtarë në vitin 1890 dhe shërben si famullitar filimisht në fshatrat e Pukës dhe më pas në Vjerdhë, Mazrrek dhe Hajmel. Në vitet 1909, 1910, 1911, 1912 ishte një figurë e njohur që u përkushtua me mish e me shpirt aspiratës së mëvetësisë dhe për këtë ka ndikuar në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe nxitjen e malësorëve të Dukagjinit dhe të Pukës në aksione konkrete luftarake. Ka qenë nxitësi dhe frymëzuesi i trazirave antiqeveritare në Sheldi me 1909¹ dhe në Zadrimë me prill të vitit 1912². At’ Pal Doda në lidhje me këto ngjarje ka shkruar :” Famullitari i Mazrreikut Dom Loro Caka së bashku me shumë trima të Mazrreikut, Sheldisë,Vjerdhës e Komanit luftuan heroikisht në Qafë Kishë të Margjelës në Vjerdhë”.³ Dom Loroja ka qenë aspirues veprime anti qeveritare në Shllak dhe Temal, në pranverë të vitit 1912 ku nga malësorët e këtyre anëve, u vra bylykbashi Sulejman Efendiu që kishte dalë për të mbledhur paratë e xhelepit.”*Dom Loro Caka kishte qit trapin mes Shllakut dhe Pukës me vu në përpjekje Mirditën me Dukagjinin*”⁴. Nga materialet historike të kohës na rezulton se Dom Loro Caka, Shtjefën Çuka e Simon Deda, në gusht të vitit 1912, i bënë thirrje popullit të Temalit, Shllakut, Shalës dhe Shoshit me u mbledhë në Mazrrek. Kushtrimit iu përgjigjën pozitivisht qindra djem malësie, të shtrënguar në istikam, të cilët zbritën si rrëketë në lumë, natën e 15 gushtit të vitit 1912. Në Kir u ndanë në tre drejtime, i pari në drejtim të Kalasë nga Tepja, i dyti tek varrezat e Rramjve dhe i treti nga kazermat e Kirit. Gjithë natën vazhdoi furia e sulmeve mbi qytet dhe vetëm në të dalë të dritës komitet u tërhoqën. “*Malësorët lanë nja dhjetë vetë të vdekur kurse ushtria turke nja pesëdhjetë*”⁵. Ka luftuar

hapur kundër malazezeve, që kërkonin aneksimin e Shkodrës. Si hyri Mali i Zi në Shkodër Dom Loroja ka vepruar ne Mazrrek dhe Qelëz duke bashkëpunuar hapur me Dedë Gjon Lulin, Rexhep Shalën, Ndoc Ndojën e Simon Dedën ⁶. Dom Lora Caka ka qenë një mbështetës i pa rezerva i Princ Vidit dhe i Kongresit Kombëtar të Lushnjës. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë pozicionohet kundër forcave esadistë në Zonën e Zadrimës, ngjarje e cila u pasqyrua



në krijimtarinë e rapsodit të famshëm të Kabashit, Prenush Gega

Ç’ është kjo luftë prej Bunjeti / Ky Ndue Hila e Dom Lareci / Thonë ç’ asht ky far kiameti /

S’biem në dorë pa u ba gazept?...

Gjatë Luftës së Parë Botërore qe partizani i austriakëve dhe për këtë me 02. 11. 1917 qe dekoruar me Kryqin e Kalorësit të Urdhrin të Framc Jozefit ⁸.

Dom Loro Caka ka marrë pjesë në luftën Ishimit dhe mobilizuar dhe mbështetur vullnetarët të Pukës dhe Shllakut në luftën e Koplikut me 1920⁹. Nga shpirti dhe vokacioni ishte liridashës dhe demokrat ndaj nuk u pajtua kurrë me pa drejtësitë që lushin në kurriz të popullit të varfër shqiptare. Zëmra i dhimbtë fort për persekucionet dhe sakrificat sublime që kishte hequr religjioni katolik, të cilin ai e konsideronte martir te vërtetë të atdheut dhe besimit. Në luftën e brendshme mes mbështetësve të Zogut dhe Opozitës ishte partizani i flaktë i pozitës, ka luftuar me të gjitha mjetet e luftës politike për Nolin dhe Gurakuqin. Ishte mik i Gjeçovit, Dom Lazer Shantojes,

⁶ “Ora e Maleve “ 1923

⁷ Epika Historike, Botim i Akademisë se Shken-cave , Istituti i Kulturës popullore, vellimi trete,, Tiranë, 1990, fq. 627.

⁸ Fletorja “Vllaznia”, Vjenë 19. 03. 1917, .vj. II. Nr. 50

⁹ “ Ora e Maleve “, 12 korrik 1924: Unë jam ai që sa muaj rresht i kam berë ballë ushtrisë Tur-kisë në luftra tëpergjakshme. Unë jam ai që kam luftuar kundër Malit të Zi e kundra Esadistve, tuj jetue rrugash dhe shpellash e tuj shkri gjia e mallë. Unë jam ai që kam marrë pjesë në luftën e Ishmit e në kohën e fundit në Luftën e Koplikut. ***Ky artikull botuar nga Vetë Dom Loro Caka ishte një replikë me një autor që Dom Loro Cakën e pergojonte së në Revolicinin e Qershorit kishte siguruar shumë më pak forca se sa kishte premtuar***

Hasan Prishtinës, Ndokë Gjeloshit, Rexhep Shalës, Vas Kirit, Spiro Kosovës, Dom Gjon Gazullit, Simon Dedës. Zhguni i fratit nuk e pengoi fare që të hidhej në Revolucionin e Qershorit, ku drejtoi mbi 100 malësorë të Shllakut, të cilët së bashku me forcat e Shalës, Shoshit dhe Pultit, të prirura nga Ndokë Gjeloshi, ju bashkëngjiten forcave të Ushtrisë Kombëtare, që i shpallën luftë qeverisë duke pushtuar Shkodrën. ” Të parën ditë të qershorit jam gjet me ushtaret e mi në pozicionin që më qe ishte kenë shënjue, prej Komandës, dua me thanë ke Xhamia e Kuqe ... Më vonë më erdhi i urdhri prej Nënkolonel Rexhep Shalës e Kapiten Sulejman Shkodrës që me nda vullnetaret në dy pjesë, një pjesë me ngjitë në Kala e një pjesë me vendos përballë Urës Baçellekut ... Me 3 qershor, sipas urdhrit të Komandës së Përgjithshme, natën mu desh me u nisë për në Va Dejës. Ndonëse dëshiri i plote i jemi dhe i vullnetarëve të mi... ishte me u nisë një ore e më parë për në Lesh, por nuk kisha se si me u largue prej Vaut të Dejës, për arsye se nuk mund të veprosha kundër urdhrit¹⁰ . Pas triumfit të Legalitetit, u arratis në Jugosllavi, ku nuk rreshti se vepruari me eksponentët më aktiv antizogistë si Mustafa Krujën, Koço Tasin, Dom Lazër Shantojën, Ndokë Gjeloshin, Spiro Kosovën, Ritvan Ohrin, Vas Kirin, Lukë Lukën, Pjetër Haxhinë, Dodë Nikollën, Kolë Bibën. Shumica e historianëve dhe studiuesve janë të një mendje se Dom Loro Caka i përkiste lobit jugosllav, ku edhe u sponsorizua për aksionin aventuresk që ka hyrë në histori si “Lëvizja e Dukagjinit”, që ishte ideuar që të shpërthente njëherazi në gjithë Shqipërinë. Ka të tjerë që Cakën e fusin në lobin italian. Nga ana tjetër rrjeti i konjunkturave italo-jugosllave në lidhje me sponsorizimin dhe tërheqjen pas hunde të Ahmet Zogut është po aq i ngatërruar e vrasës sa rrjeti i merimangave të zeza për insektet. Gjithsesi, pozicioni i Dom Loro Cakës ka mbetur i shumë debatuar deri në mister, i mallkuar si ideatori i kantonizimit të Shqipërisë, sipas përbërjes religjioze, i demaskuar pamëshirshëm dje dhe në vazhdim si nxitësi i një lëvizje seperatiste më synime të mbrapshta antikombëtare. Akuzat ndaj Dom Loro Cakës në lidhje me kantonizimin ndonëse nuk janë të pabaza. por denigrimi politiko-fetar ekstremist kanë qenë e mbetën akoma të tejskajshme duke çekuilibruar pothuajse çfarëdo lloj arsyetimi të ftohtë e të paanshëm. Dom Loro Caka, Dom Lazër Shantoja por edhe disa klerik dhe jo pak intelektualë të dëshpëruar të mërgatës politike me një Zvicër ballkanike kërkonin të mbronin tregun vendas nga ekspansioni i kapitalit italo-anglez, i cili duhet pranuar se iu lëshua ырysh Shqipërisë derisa më në fund humbi totalisht dhe pavarësinë me 1939. Dom Loro Caka nuk ka qenë i pari as i fundit për idenë e një katonizimi të Shqipërisë, prandaj nuk ka qenë diçka konspirative ideja për një lidhje kristiane. Ekzistencën e saj na bën me dije edhe At Bernardin Palaj, i cili e nënvizon këtë fakt duke shkruar: “*Ekzistenca e këtij programi rezulton edhe prej një letre që çonte Dom Loro Caka drejtpërdrej N. Mjedës në muajin Gusht, me anë të konsullatës jugosllave ... Këto dokumente*

¹⁰ “Ora e Maleve”, 12 korrik 1924.

*mjaftofshin për me kualifikue iniciatorët e lëvizjes prej krahit të Jugosllavisë.*¹¹

PROGRAMI I KRYENGRITJES (REVOLUCIONIT) TE SHKODRES

Dom Loro Caka para shpërthimit lëvizjes se nëntorit 1926 ua ka bërë të ditur bashkëpunëtorëve programin si vijon

A-Rrëzimi i regjimit të Zogut.

B-Formimi i qeverisë provizore demokratike antifeudale nga forcat revolucionare, deri në zgjedhjet e përgjithshme.

C-Përkrahja e klasës punëtore të shtypur nga bejlerët, agallarët çifligarët dhe luftë të pamëshirshme kundër çdo keqbërësi në popull.

Ç-Shpallja e Republikës së Shqipërisë pa të drejtë ndërhyrje nga jashtë në punët e brendshme *D- Anulimi i menjëhershëm i çdo marrëveshje të dëmshme të kohës së regjimit zogist, që cenon tërësinë tokësore dhe interesat e shtetit shqiptar nga ndonjë shtet i huaj*¹².

Mustafa Kruja, një nga mendjet me ndritura të atyre viteve për Lëvizjen antizogiste të vitit 1926 shkruan: “Askush me mire se unë Koço Tasi nuk ka qenë informuar për Lëvizjen e Shkodrës. Deri tash vonë gjithë nacionalistet kanë qenë të bindur se shembja e A. Zogut nuk mund te realizohej pa ndihmën e një ndërhyrje te jashtme. Shumica jonë kemi menduar se kjo përkrahje do të gjëhej pa cenue interesat vitale kombëtare dhe krejt kemi qenë te mendimit se Kryengritja jonë nuk varej nga rreziku i një ndërhyrje te jashtme”¹³.

Ndërsa një nga eksponentët kryesor të këtij revolucioni, Spiro Kosova në kujtimet e tij historike ka shkruar: “*Dom Loro Caka kishte marrë përsipër organizimin e kësaj kryengritje dhe ishte në marrëveshje me Koço Tasin, i cili do të organizonte lëvizjen nga ana e Jugut*”. *Dom Loro Caka mbajti një fjalim të shkurtër e plot kuptim, të cilin e mbylli me shprehjet: Në qoftë se na dhimbet atdheu dhe populli shqiptar, duhet të veprojmë dhe ja siç duhet bërë. Bafti i Zotit dhe pushka e Hotit.*”¹⁴

Me 11 nëntor, Dom Loroja kalon kufrin, me 15 nëntor me disa shoqërues arriti në Dukagjin, ku u takua me Vas Kirin e Ndokë Gjeloshin. Natën e parë kanë fjet tek Nikë Marashi prej Gimajve që ishte mik i ngushtë i togerit, i cili ka të fshehur 5 armë në shtëpinë e tij dhe një arkë municion. Ndërsa natën e 17-18 nëntorit ata e kaluan duke bërë takim me popull në Shalë e Shosh”¹⁵. Në zonën e Dukagjinit Dom Loro Caka, si klerik, kishte shumë prestigj, si patriot dhe kundërshtar i regjimit zogist (*madje shumë më tepër se duhej nënvizimi im P. M*). (vijon në numrin e ardhshëm)

Prelë Milani

¹¹ Bernardin Palaj, “Hylli i Dritës”, .Nr 13, viti 194, fq- 253

¹²MarenglenVerli, “Shqipëriaevitet1912-1964, në kujtimet e Spiro Kosoves” , vellim pare, botim i Klean sh.p.k, Tiranë viti. 2008, fq. 328

¹³ Mustafa Merlika Kruja “Gjysmë shekulli me pendë në dore”, Botim OMSCA-1 Tiranë 2015, fq 394.

¹⁴ “Liria Kombëtare” , fq. 207-208

¹⁵ AQSH Fondi MPB, Dosja 5|1, dok 31, date 20 . 11. 1926.

Takim i Forumit Rural Shkodër

Në mjediset e hotel Colosseo Shkodër me 18 shtator 2015 zhvilloi punimet e tij Forumi Rural Shkodër. Ky forum, i krijuar para 12 viteve, mbledh fermerë, përfaqësues të shoqatave të ndryshme që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonat rurale si dhe specialist agronom, zooteknik dhe veteriner. Aktiviteti i forumit kishte si qëllim riorganizimin e tij sipas territorit të Bashkisë së re. Përshëndetjen dhe njohjen me programin e aktivitetit e bëri drejtori i fondacionit AFTD, Fatos Fico, nen kujdesin e të cili është ngritur forumi. Me pas e mori fjalën Kryetarja e bashkisë Shkodër, z. Voldana Ademi, e cila i njohi të pranishmit me ndryshimet e reja territoriale ku tashmë 50% e popullsisë ndodhet në zona rurale. Funksionimi i pushtetit vendor në kuadër të reformave të reja të bashkive, ku me ligjin e ri mendohet që bashkia do të drejtojë kadastrën, ujitjen, statistikën bujqësore, krijimi i grandeve, shërbimi veteriner, kullotat, etj. Kompetencat e vendorëve japin mundësi të reja të drejtimit në administratat territoriale të ish komunave. Me pas ajo ju kërkoi të pranishmeve të shprehin mendimet e tyre, të flasin

për vështirësitë që ato ndeshin në punën e tyre duke i konsideruar si bashkëpunëtor për ndër-

Mustafa Kraja, ka shpjeguar para këtij forumi gjendjen e bujqësisë të rrethit Shkodër, ku ka

kanë pasur prioritet kryesor kulturat e misrit e foragjereve si dhe bletët e bimët aromatike e medicinale. I vetmi tregues pozitiv i dy viteve të fundit ka qenë tregtimi i gështenjes në tregun e jashtëm. Në blegtori ka tendenca të shtimit mbi 50 krerë të imta e 10 krerë lopë nga fermerët në ndryshëm. Më pas specialistja e kësaj drejtorie Mili Mandija ka dhënë detaje mbi zhvillimin në tërësi të bujqësisë dhe blegtorisë të këtij qarq. Në këtë forum të pranishmit janë njohur me ligje e reja të vendosura nga pushteti qendror si pajisja e fermerëve me NIPT nga çdo fermer që del në treg me prodhimet e tij. Në këtë forum u trajtuan disa mangësi e vështirësi nga grupimet e fermerëve siç është dokumenti i pronësisë së tokës, nxitja e fermerëve për tu bashkuar në shoqata të përbashkëta, etj. Përvojë jo e mirë vitet e fundit ka qenë prodhimi i shalqirit, domates e i sherbelës, ku shoqatat prodhuese nuk kanë arritur të shesin prodhimet e tyre. Gjithashtu pjesëmarrësit e këtij forumi janë njohur me projektin: Mbështetja për bujqësinë dhe zhvillimin

rural në zonat e pa favorizuara në Shqipëri, i projektit SARED, me qëndër në ambientet e drejtorisë së bujqësisë Shkodër. Specialisti Hysen Gushta, drejtues i këtij projekti ka shpjeguar objektivat dhe kushtet ku fermerët dhe shoqatat e ndryshme mund të përfitojnë grandet e akorduara nga qeveria e Danimarkës dhe Gjermanisë, në këto fusha: 1. Ripërtypësit e vegjël. 2. Pemët frutore dhe arvore. 3. Bimët medicinale aromatike. Duke filluar nga 1 tetori i këtij viti gama e projektit përfitues nga 1 arror bëhet 10 arvore e nga 10 bimë medicinale në 40 bime medicinale. Në analizat, diskutimet e përfaqësuesve të OJF, specialisteve të ndryshëm u identifikuan shqetësime që takojnë njerëzit që investojnë në fushën e bujqësisë e blegtorisë. Mjaft shqetësues mbetet kërkesa ndaj qeverisë për përmbytjet. Ky forum nxori në pah se fermerët duhet të dalin në treg me prodhime BIO dhe prodhime lokale si çelës i sukseseve në të ardhmen. Pjesëmarrësit gjatë seancave të pushimit kane shijuar verën e prodhuar nga "Vreshtarët e Zadrimes" Hajmel të përfaqësuar nga Zef Pashuku si dhe djathin e blegtorit Tom Pjetrani.

Ne këtë takim mori pjesë dhe kryetari i Shoqatës Atdhetare-Dukagjini, Ndue Sanaj dhe Sekretari i Këshillit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", për çështjet organizative, Alesk Dushi.

Përgatiti Zef Nika



timin e alternativave me të mira për zhvillimin e zonave rurale. Drejtori i bujqësisë Shkodër,

një sipërfaqe prej 46059 ha me toke arë, pemë frutore, ullishta, vreshta e drithëra. Fermerët

FLETËLAVDËRIME ME ...

- VËZHIM -

Të vlerësosh punën dhe rezultatet pozitive të brezave, apo edhe të bashkëkohësve është një gjë shumë e mirë. Njeriu ka nevojë dhe shërben si nxitje që të vlerësohet edhe sa të jenë gjallë. Kjo motivon, e bën të ndjehet mirë, edhe vetë personin por nxitë edhe të tjerët, publikohen vlera dhe motivon për punë të mëtejshme të personit që vlerësohet por edhe të tjerëve, pasi mendojnë se puna e tyre nuk do të mbetet në harresë. Kanë dhënë ndihmesë mjaftë të madhe shumë persona, pse jo edhe personalitete. Më ka mbetur në mendje një bisedë që bëme një ditë me Ndue Marashin, i cili e kishte menduar dhe propozoi që

Shoqata Atdhetare Dukagjini të vlerësojnë me mirënjohjen e saj, këngëtarët Artiola Toska dhe Poni. Ato nuk janë nga Dukagjini, por sipas Ndues, dhe kjo është e vërtetë, kanë kënduar këngën "Fol Shqip", një këngë që bën thirrje shumë të fuqishme në mënyrë artistike dhe të hapur, që njerëzit tonë, bashkëkombësit kudo që ndodhen të mos e harrojnë dhe të flasin shqip, por që duhet tua trashëgojnë edhe fëmijëve të tyre, propozim vërtetë me shumë mend dhe me shumë vend, kjo edhe për faktin se kemi një largim shumë të fuqishëm të djemve dhe vajzave nga zona e jonë për në vende të ndryshme të botës ku kanë ndërtuar jetën e tyre, familjet e

tyre, kanë lindur fëmijët e tyre, e që duhet të mos e harrojnë gjuhë e bukur shqipe.

Kur njeriu ka bërë një punë, ka kryer një akt shembullor për të mirë, ka treguar vlera në fusha të ndryshme me vlera shoqërore dhe shkencore është me shumë vend që të propozohen dhe të vlerësohen. Propozimet dhe dhënia e vlerësimeve është mirë dhe më shumë rezultateve që të bëhen në kohën e duhur, në vendin e duhur por edhe për personin e duhur. Nuk ka se si të nderohet një person kur organi që e jep këtë vlerësim nuk ka njohuritë e duhura, kur personi që e propozon nuk ka mundësinë e duhur e marrë në të gjitha drejtimet.

Në këtë vëzhgim do të vë përballë dy fenomene që janë shfaqur dhe vazhdojnë jehonën e tyre edhe pasi kanë mbaruar ligjërisht veprimtaria e ish komunave dhe këshillave të tyre, të cilat kanë edhe të drejtën e dhënies së këtyre vlerësimeve. Në njërin anë qëndrojnë ata që kanë dhënë me pakicë dhe nga ana tjetër kemi ata që kanë dhënë shumë, mbase me shumicë.

Në komunat e zonës së Dukagjinit mund të numërohen më gishta personat që kanë marrë vlerësime prej tyre, në katërvjeçarin e fundit të punës së tyre. Janë me dhjetëra persona, djem e vajza, burra e gra, të moshuar dhe të rinj që kanë punuar në fusha të ndryshme me përkushtim, që kanë lënë edhe trashëgimi me vlera dhe nuk janë vlerësuar, pa përfshirë edhe ata që janë ndarë nga jeta. Ka pasur edhe propozime

konkrete, dhe në këtë drejtim nuk mund të ankohen, por, nuk janë marrë parasysh.


Nga ana tjetër shikojmë shpërndarjen e shumë vlerësimeve në komunat e Mbishkodrës afër qytetit, duket se kanë qenë më të ndjeshëm, kanë dhënë me shumicë, sa do të thosha se mungesat në disa komuna që i përmendëm më lart janë tejkaluar nga shpërndarja me shumicë në këto të tjerat. Vlerësimet janë me rëndësi dhe duhet dhënë, por kur kalohet masa prishet cilësia.

U uroj suksese dhe vlerësime të tjera të lauruarve, me qëllim që të bëhen nxitje dhe vlerësime reale për shoqërinë. Por do të dëshiroja që të kemi më shumë vlerësime, tashmë, nga Bashkia Shkodër edhe në ato zona që kanë munguar ose janë dhënë me pakicë.

Luigj SHYTI

MALLI, SHPRESA DHE DASHURIA

MENDIME, KOMENTE DHE KONSIDERATA PËR VËLLIMIN POETIK “LAMTUMIRË MOS THUAJ”, TË L. SHYTIT



nga Ndoc Logu

“Më fal baba,
Se vonë të erdha te varri,
Ndoshta ke menduar,
Më paska harruar djali
...
E di se fjalët i merr era,
Dhe lulet do të vyshken një ditë,
Por mallin dhe kujtimin tënd,
Gjithmonë i kam në shpirt...”
(Nga poezia; “Më fal baba”) dhe babai sikur i përgjigjet:

“...Njeriu s’jeton gjithmonë,
Por, kudo jam unë,
Në murin e arës apo kullës,
Në këngë, luftë e punë...”
(nga poezia “Ta kisha babin”)

Në një nga ditët e fundit të qershorit ndodhesha në ish turizmin e Shkodrës. Përballë kisha poetin e vargjeve të mësipërme. Ai, sapo më kishte dhuruar librin e tij me poezi; “Lamtumirë mos thua”. Ndërkohë që ai vazhdonte dedikimet edhe për dy libra të tjerë, se si u përhumba te titulli i këtij libri. “Lamtumirë mos thua” më dërgoi diku larg si distancë, por akoma më larg si kohë; 90 vjet të kaluara dhe në Shën Peterburgun e magjishëm dhe të largët, pikërisht për një varg a një poezi të tillë.

Pak ditë para se të takoja poetin, sapo kisha përfunduar një material lidhur me rrethanat e vdekjes së Sergei Esenin në vitin 1925 në Shën Peterburg. Deri së fundmi e dinim se Esenini, gjoja para vetëvrasjes, na kishte shkruar një poezi me tetë vargje, që më vonë studiuesit i vunë titullin “Dasfidanja” (Lamtumirë), i marrë nga vargu i parë i strofës së dytë (në përvjetorin e tij do t’i paraqes lexuesit, të vërtetën e kësaj vrasjeje). Tani fjala nuk është te vrasja por tek titulli “Lamtumirë”. Poeti rus fjalën lamtumirë e përdorë si fjalën e fundit për t’u ndarë një jeta e vërtetë, nga jeta reale. E si për çudi, edhe poeti tjetër rus A.S.Pushkin, që vdiq më 1837, fjalën e fundit kishte thënë: “Vdekja po vjen ... lamtumirë”. Por edhe poeti ynë, Ndre Mjeda, e përdorë fjalën lamtumirë në një poemë. Por, ne jse, mund të flasim në vijim edhe për këtë. Ndërsa poeti shqiptarë, Luigj Shyti, fjalën “lamtumirë” i thotë Artës, mos e thua, se kjo fjalë është e rëndë, sepse nënkupton moskthim. Lamtumira e Eseninit është moskthim, lamtumira e përrjetshme është

disfatë, është, siç ka thënë një ushtar i Napoleonit, heqje vullnetarisht dorë nga jeta. Lamtumira në poezinë e poetit Luigj Shyti kërkon të mos thuhet:

“...Lamtumirë mos thua,
Kështu i thuhet ati që zbret në varr,
Mirë u pafshim, thua.
Kjo mban shpresën gjallë...”
(Nga poezia “Artës”)

Kështu, që nga titulli domethënës, deri te vargu i poezisë së 90të të librit, të mban lidhur si magneti pas metalit. Madje shpeshherë, të vë në mendime e ju kthehesh herë pas here ndonjë poezie a vargu, për ta kuptuar më mirë mendimin e mesazhit të poetit. Vetë titulli është intrigues, sepse nuk është marrë nga titulli i ndonjë poezie, siç ndodh me shumë poet të tjerë, por është marrë nga një varg, më qartë nga vargu i parë i strofës së fundit të poezisë kushtuar Artës. Unë nuk e di çfarë lidhje ka poeti me Artën (personazh i poezisë), është vajza e vet apo emër simbol i poetit, por sido që të jetë është një gjetje e mençur që ngre në art një plagë mjaftë të madhe, të rëndë, e që rëndon në shpirtin e të paktën të gjysmës së shqiptarëve, siç është emigracioni, ku përfshinë edhe vetë poetin. Pa mëdyshje, kjo e fundit, ja ka therur shpirtin poetit, Arta veshur me të bardha, ikën përmbi male e dete drejt vendeve të huaja. Ndaj shpirti i poetit e ndjen thellë dhimbjen e largimit. Për këtë arsye, ju lutet; “Lamtumirë mos thua”, se kjo fjalë është trishtuese për poetin dhe gjithë ne.

Gjithsesi, edhe në se poeti niset nga ky rast i përvetshëm, që në fakt nuk është i tillë, nga dhimbja e shpirtit të vet për fëmijët, poezia e publikuar, ka preokupimin e mbarë shoqërisë tonë. Dhe kur poezia shprehë aspiratën, dhimbjen e shpresat e kohës dhe të shoqërisë ku jetojmë, atëherë, poezia, në këtë rast poeti, ja ka arritur qëllimit, e ka kryer misionin fisnik, pra ka arritur në artin poetik, një dukuri jetësore të kohës kur dhe ku jetojmë. Por le të kthehemi në brendësinë e vëllimit “Lamtumirë mos thua”, te poezitë që realisht meritojnë vëmendje dhe janë një realitet jetësor, por që janë edhe mjaftë aktuale.

Poetët i kanë konsideruar si vullkanet, që kur akumulojnë energji në brendësi të tokës, shpërthejnë. Edhe poetët, kur akumulojnë në shpirt ndjenja, emocione, entuziazëm, dhimbje e shpresë; energjitë e shpirtit i shprehin në vargje si dëshmi e preokupimit qytetar e atdhetar, për atë dhe ata që i përjetojnë realisht në emocionet e veta. Kështu, tëra poezitë e L. Shytit që këtej e kanë burimin, të shpirti i trazuar, te malli, te revolta për të, dhe ata që poeti e gjykon me vend, te shpresa dhe besimi absolut me mundësinë e njeriut të vetëdijshëm për të ardhmen më të mirë. Pjesën më të madhe të ideve të mësipërme shprehen qartë e bukur të poezia me titull “Poezia ime”:

“...Shëtis nëpër kujtimet e mija,
Bashkoj dromca nga jeta,
Ndonjë çast të bukur, nga vetmia,
Nga dashuri apo urrejtja.”

Apo te poezia tjetër “Vargjet e mija” që

autori janë vargjet:

“Si kokrrat e misrit fukaraja,
I mblodha vargjet e mija,
Nëpër rafte e kuti, fletët të zverdhura,
Të grisura, të pluhurosura, që nga rinia.
...
Ngado, nëpër truallin tim,
Si blea punëtorë, u përpoqa të mbledh,
Me dëshirë, me mall e përkushtim,
Fjalë zemre, djersë e lot për të sjellë.”

Vargjet e mësipërme shprehin formimin e botëkuptimit e poetit mjaft qartë, e nga ana tjetër, për të na thënë, ne, lexuesve, se si i ka rrjedhur poezia në truallin e vet, me dashuri, me mall e përkushtim, nga ku rrjedhin fjalë zemra, djersë e lot, dukuri, këto, të poetëve realist.

Është shumë interesant, dhe një befasi e këndshme për mua, se në këtë vëllim, Luigj Shyti, ka lëvruar me sukses disa nga ato që ndahen, brenda vetë poezisë si nën degë, ose degëzime të saj, të cilat unë do ti quaj si poezitë e mallit, shpresës, lirika, ato sociale, dedikime, emigrimit, por edhe të tjera, si të revoltës. Gjithsesi, edhe pse nuk janë ndarë në cikle më vete, lexuesi i vëmendshëm i dallon fare lehtë, sepse secila në vetvete e të gjitha së bashku, përbëjnë merakun e poetit, por edhe preokupimin për ti ndarë me lexuesin, ku shprehet qartë, thjeshtë dhe me sinqeritetin e një fisniku të edukuar kur shkruan:

“... Sa të arrira, lexuesi mund të thotë,
Çdo gjë për tu arrirë do punë,
Bëra atë që munda unë,
Të tjerët të thonë atë që duan.”
(Nga poezia “Vargjet e mija”)

Në aspektin e të pasur sukses apo jo të poezisë, ka shumë rëndësi, krahas temës që trajton, edhe gjuha, vargu, ndërtimi, struktura e poezisë, rrjedh lirshëm apo e sforcuar, vargje të kuptueshme apo hermetike, që trajton njeriun me botën e tij apo fluturimet abstrakte e jashtë realitetit. Mjaft poet kanë dështuar, ose shfaqen në fillim dhe harrohen shpejt për efekt të mangësive të mësipërme dhe e kundërta. Ka jo pak të tillë që e hedhin të zezën mbi letër pa e dituar as vetë se çfarë po thonë, pa ide të qarta, me vargje abstrakte, me temë pa vlerë e shpesh herë edhe banale, që as të ngrohin as nuk të ftohin, por më shumë të revoltojnë, siç po ndodh këto mbi 20 vitet e fundit. Në këto aspekte, poezia e Luigjit, ka një fat të lumtur, sepse pjesa më e madhe e poezive të vëllimit “Lamtumirë mos thua” që janë shkruar kanë pasur si burim nga një përjetim real të poetit, nga një legjendë apo kujtim, një histori apo dukuri të jetës shoqërore në mjedisin ku ka punuar dhe jetuar poeti. Përveç kësaj, mjaftë poezi të Luigjit, janë shkruar në gjuhën e bukur e të thjeshtë të popullit, lehtësisht të kuptueshme nga të tëra moshat dhe shtresat e popullsisë. Ky fakt është një avantazh që krijimtaria e L. Shytit, të lexohet dhe kuptohet nga masa e madhe e atyre që e marrin në dorë, duke filluar nga nxënësit e shkollës e deri te më i dituri. Kjo gjuhë, pra gjuha popullore, mendoj unë, është e zgjedhur nga poeti, ndër të tjera, edhe për faktin se jo pak personazhe që poeti ju kushton poezitë, janë njerëz

real të jetës tonë si; prindi, fëmijët, nënës e mësuesit, heronj e ngjarje, vende e natyra të bukura, kulla roje, male me borë e pisha shekullore, uji i kulluar e freskia alpine, legjenda të bukura e fisnikëri malësore, mikpritjen e nderin për sofrën e shtruar të Dukagjinit, fshikullim i dukurive të shëmtuara në jetën tonë, veçanërisht ato me ndikime politike. Të gjitha këto janë vlera, aspekte jete, plagë e përjetime që me të drejtë poetin e kanë shqetësuar, frymëzuar dhe angazhuar.

Në vëllimin poetik të zotit Luigj, “Lamtumirë mos thua”, ka jo pak poezi, ndonëse janë përjetime të vetë poetit, ato, i kapërcejnë kufijtë e ndjenjave individuale. E tillë është poezia me titull “Mirupafshim”. Poezia, është përjetim i autorit, poetit, vite më parë, kur poeti largohej nga vendlindja, nga Dukagjini për në qytetin Shkodër. Në këtë rast autori nuk harron asgjë dhe askënd pa ju thënë mirupafshim, Shalës e Shoshit, Radohinës dhe Zorjgit, bjeshkëve me borë, Thethit piktoresk, deleve dhe ujit të kthjelltë, arave dhe prenjëve, dragonjve dhe zanave, gjithçkaje të bukur që ka jeta dhe Dukagjini. Kjo poezi më kujton fëmijërinë time të hershme, e pse jo edhe të vëllezërve të mijë dhe mijëra të tjerëve që janë larguar nga Dukagjini, për tu shkolluar, e natyrisht, edhe për një jetë më të mirë. Gjithsesi, edhe pse ka kaluar më shumë se një gjysmë shekulli që jam larguar nga vendlindja ime, emocionet e poetit i përjetoj edhe unë deri në lot. Sikur vetëm kaq, sikur vetëm për pak njerëz të gjenin veten në këtë poezi, merret me mend sa jetësore është dhe sa jetëgjatë mbetet ajo. Por largimi i poetit L. Shyti, siç thotë poezia, është dinitoze. Ai nuk largohet pa e kthyer kokën prapa, si ndonjë tjetër, apo siç ndodhi me poetin Xh. Bajron i përbuzur nga Anglia. Poeti ynë shprehet:

“... Mirupafshim, më falni shumë,
Mirupafshim, se unë po shkoj...”

thotë autori nga fundi i poezisë dhe, më pas përfundon;

“... Eh kjo “rruga orok nuk ka”.
Mirupafshim, por do kthehem,
Se kjo zemra, shpirti im,
Veç këtu e gjen prehen.”

Sapo lexova këtë poezi të përmallshme të Luigjit, mu kujtua poema e Ndre Mjedës “I treturni”, ku midis të tjerash ai shprehej:

“...Lamtumirë o mori Shkodër,
Lamtumirë o ti Cukal,
Zhduket Buna nën një kodër,
Zhduket Drini nën një mal.
Lamtumirë o ti nënëshkreta,
Që me t’vështira m’rrite kaq,
N’kohë ma t’mirë për ty, unë, treta,
Kur pleqnja kërkon paqë...”

S’ka dyshim se poezia e Luigj Shytit e ka burimin tek një përjetim i thellë i tij që largohet nga vendlindja. Por ndryshe nga Mjeda, që i thotë “lamtumirë” Shkodrës e Cukalit, Bunës e Drinit, nënës së vet “që në të vështira e rriti kaq”, poezia e Luigjit nuk e thotë asnjëherë, dhe asgjëkund fjalën e moskthimit “Lamtumirë”. Ai e ka zgjedhur fjalën “Mirupafshim”. Jo vetëm kaq, Luigji kërkon falje dhe ju premtos se do të kthehet, sepse vetëm tek vendlindja gjen prehen. Por, mesa duket edhe kjo nuk është e mjaftuar për poetin. Ai përsëri ndjen mall, ndjehet edhe disi si “fajtor”.

Vijon në numrin e ardhshëm

BANORËT E FASHTIT DERRAJ, NË DOMËN KANE ORIGINËN NGA FSHATI LOTAJ – SHALË

Është një fshat i vogël, poshtë Qafës së Thanës, midis Domnit dhe Shakotës, sipër Rrosekut, që quhet Derraj. Më shtyri interesimi, si edhe për shumë fshatra dhe zona të tjera, që ka lidhje me shpërndarjen e banorëve të fshatit Lotaj të Shalës në shekuj, siç është rasti i Jubanit, Dajçit të Bregut të Bunës, familjen Koliqi në Shkodër, Lotajt në Velikë, në Ulqin buzë lumit Buna, Dinoshë, Nju Jork, Lotajt në Abat të Shalës, Lekaj. Shkak për të gjurmuar për fshatin Derraj u bë një kafe me bashkëfshatarin tim, Vuksan Gilaj. Në tavolinën tonë erdhi një shok i Vuksanit, që më tha se ky është nip në Lotaj. U çudita dhe menjëherë e pyeta për më thellë në këtë drejtim. Ai foli gjithë pasion e dëshirë. Ai tregoi se nëna ë tij është bijë nga Lotajt e lagjes Derraj në Domën. Rreth 250 vjet më parë, tregon ai, dy vëllezër në moshë të re për arsye mbrojtjeje nga gjakmarrja apo thjeshtë për të gjetur punë, erdhën në Domen dhe fjetën. Ata erdhën nga drejtimi i Qafë Thanës. Në këtë drejtim sqaron edhe plakun 104 vjeçar nga fshati Domen Ibrahim Shabani, që me gjithë moshën e madhe ishte në gjendje shumë të mirë shëndetësore dhe i kthjelltë në mendime. Duke vazhduar idenë e ati nipit në fshatin Derraj që përmendëm më parë, shpjegon se këta dy djem, stërgjyshi i Brahimit, për arsyen se përse kishin ardhur në këto anë. Pas disa bisedash, i zoti i shtëpisë u thotë që po deshën mund të punojnë këtu, duke u siguruar fjetjen ushqimin dhe një pagë të vogël. Djemtë pranojnë, dhe pasi punojnë për 4-5 vjet, i zoti i shtëpisë u propozon që të martohen, por me kusht që të ndryshojnë besim nga katolik në mysliman. Ata pranojnë dhe martohen më dy vajza që atyre u pëlqyen. Njëri nga vëllezërit kishte emrin Kolë Gjoni, tjetrit bashkëbiseduesit tonë nuk ja kujtonin emrin. Edhe sot është një kodër që quhet “Kodra e Kolë Gjoni”, në rrugën që të çon në Bjeshkët e Domnit.

Kur familjet e këtyre dy djemve u shtuan duke lindur fëmijë dhe në pasuri, mbledhen të parët e fshatit dhe vendosin që tu falnin Pyllin e Derrave, sepse ka ujë, ka tokë që mund të punohet, ka vend që të mund të mbajnë bagëti. Ne duhet ti mbështesim që të mund të jetojnë sepse kemi vajzat aty dhe fëmijët e tyre janë gjaku ynë, mendonin të parët e fshatit. U vendosën kufizimet e vendbanimit të tyre, që nuk kanë lëvizur deri sot. Fshati Derraj përbëhet nga dy lagje që quhen Katurrel dhe Shullanaj.

Lagja Shullanaj kufizohet me Shakotën, në Fusha të Rrosekut, përsipër Rrethit të Derrave, në Shtiq te Shpella e Derrave e në Lamë të Sheut. Kjo lagje ka vadën që buron te Rrethi i Lamit të Gomarit.

Lagja Katurrel kufizohet me Domnin për vijë të vadës e të Gjollat e Zeza, të Lami në Fushë të gurtë, për rrugë e nën Maje të Qukeve deri të Boka e kuajve, Kroni i egër e në Rrugë të Derrave te Lami i Ali Hasës dhe bashkohet në Fushë të Rrosekut në formë rrethit. Katurreli ka vadën që buron te Gurra e Derrajve. Këta

kanë edhe disa puse që mbledhin nga pak ujë.



Guri Katurrel Derraj

Është interesant se ky fshat nuk ka pjesë tradicionalisht në bjeshkë për shfrytëzimin e saj për blegtori apo të tjera drejtime. Ky fshat ka ujë të pijshëm dhe më i rëndësishmi është Kroj në hyrje të fshatit. Para disa kohë ky fshat ka marrë ujin nëpërmes ujësjellësit rrëzë Malit të Maranait. Sipas të dhënave që mundëm të grumbullojmë nga bashkëbiseduesit tonë, prej shumë brezave në Derraj nuk ka pasur asnjë vrasje apo grindje. Ky fshat ka harmoni shumë të madhe midis banorëve.

Fshati Derraj në vitin 1971 ka pasur 17 shtëpi, ndërsa sot janë rreth 50 shtëpi. Vetëm 2-3 familje jetojnë në mënyrë të përhershme gjatë gjithë vitit, të tjerat kanë krijuar mundësi banimi në zona fushore dhe në qytet, por që dalin çdo verë dhe merren me punët e tyre bujqësore apo blegtorale.



Pamje nga fshati Derraj

Banorët i çojnë brezat mjaftë thellë, konkretisht deri te mbiemri Kuturreli, që lidhet me një gurë shumë i madh dhe mjaftë interesant, në të cilin ka edhe shenja të besimit fetar, siç mund të shikoni edhe në foto. Të gjithë vëllaznit i çojnë brezat deri të Dema. 74 vjeçari, Haxhi Lici, thotë se e kemi pasur mbiemrin “Dema”, por kur u bamë regjistrimet pas çlirimit në e vunë “Katurreli”. Mendohet se është e mundur që te brezi “Dema” mund të bëhet lidhja me Kolë Gjoni, duke e krahasuar edhe brezat e tjerë të Lotajve që janë në Dajç të Bregut të Bunës, në Juban, etj. Në këtë mendim është edhe Bajram Shabani.

Haxhi Musa, 87 vjeç dhe i rënduar në gjendjen shëndetësore, i pranon këto që kishim mbledhur, por shton se i vinte keq që i kishte harruar emrat e katër Lotajve që kishin shkuar në këtë vend në kohën e Zogut, që ishin të interesuar për gjendjen dhe sigurinë e tyre, duke u premtuar ndihme sa herë që kishin nevoja, sepse e dinin se jemi të një gjaku. Për prejardhjen e këtij fshati nga Lotajt ka treguar edhe

Nik Vuksani nga Gimajt. Më erdhi shumë keq që Haxhi Musa u nda nga kjo jetë vetëm tre ditë pas takimit që pata me të. Ai qoftë mirë me Zotin dhe familjarët e të afërmit kjoshin dhe e kujtofshin.



Haxhi Musa 1928-2015

Të gjitha ata burra më të cilët bisedova, për 2-3-ditë, binin në një mendim për prejardhjen nga Lotajt, madje shpesh herë na kanë quajtur “Shala e Vogël”, thoshin ata.

Sipas të dhënave të mbledhura në Derraj kemi këta breza:

Katurreli: 1. Sodenisi, 2. Hyseni, 3. Naxhi, 4. Lici, 5. Hyseni, 6. Tahiri, 7. Hasani, 8. Dema

Shullanajt: 1. Zeneli, 2. Haxhi, 3. Musa, 4. Zeneli, 5. Haxhi, 6. Ahmeti, 7. Bajrami, 8. Cmajli, 9. Dema

Siç e përmendëm edhe pak më parë, nga brezi i nëntë, mund të vazhdohet: 10- Kolë, 11- Gjoni, dhe ky i fundit mund të lidhet me Gilën në Lotaj të Shalës.

Po shënojmë edhe disa toponime nga ky fshat, si Mali me Shenj, Kodra e Kolë Gjoni, Boka e Kishës, Katurreli, Arat dhe Rruga e Stakajve, Lisi i Cilikokut, Shokëzat që janë në fund të Darrajve,, sipër Rrosekut që bien kryqet shumë të thellë dhe shumë të vjetër.

Ky fshat ka pasur shumë persona më emër, të njohur, të urtë dhe të besës si Lis Hasani, Zenel Haxhia, Zek Bajrami, Bajram Derri, e shumë të tjerë.

Gjatë Luftës për çlirimin e vendit kjo lagje ka qenë bazë mjaftë e rëndësishme dhe strehuese e luftëtarëve, si shtëpia e Mus Zenelit, Haxhi Licit, etj. Interesante ishte edhe shpella të Mrizi i Dhive, në një përrua të thellë, në të cilën edhe sot ishin gurët që janë përdorur për të fjetur, Xhevdet Gavoçi, Qazim Kapisyzi, Bilal Parruca, Tomë Kola, etj. Kujtohen më respekt pjesëmarrësit në Luftën për çlirim të Shqipërisë, Zek Zeneli, Bajram Derri, Mus Zeneli, Nife Zeqiri, nëna e Haxhi Musës, Sadri Ademi, Myrto Zeneli, e te tjerë.

Përgatiti, **Zef Lulash Sokoli**

NANA DHE HANA...

- Sofisë në dhjetëvjetorin e vdekjes -

Një hanë e plotë në qiell ndriçon si një medalion përmbi male varë prej nga lart diku një kryq po shikon plot në katër copa nga kryqi e ndarë.

E ndarë si zemra që varri mbulon që ditën që iku dhe të vetëm na la krahëhapur në heshtje kryqi po qëndron me hanën e zbehtë sikur flet diçka.

Ti dëgjon o hanë që rilind çdo natë dhe kupën e qiellit ngadalë e përshkon të lutem ndaloje udhëtimin tand të gjatë përmbi këtë varr ku një nanë pushon.

Ndalo dhe dëgjoje çfarë kërkon të thotë më duket të pyes, diçka po kërkon ty që bujarisht e ndriçon këtë botë dhe çdo gjë qartësisht nga lart e shikon.

Dhe hana e ndali të gjatën rrugë të saj përmbi varr si pezull për një çast qëndroi një zë që po dilte nga varri me vaj me dhimbje e mall të fliste filloi.

Të lutem më thuaj o e bukura hanë në udhëtimin tand a thua ke pa tre fëmijë jetima që mbetën pa nënë se nana ju vdiq dhe jetim i la.

Më thuaj si janë, thuajm a janë rrit ka gati 10 vjet që unë si shikoj a thua për mua ndopak janë mërzitë apo që kur vdiqa gjithkush më harroi.

Heshti pakëz hana dhe lotët i fshiu dhe përmallshëm nisi të flasë me ngadalë nga thellësi e shpirtit lodhshëm psherëtiu dhe ashtu në vaj seç tha disa fjalë.

Ti o nanë mos qaj dhe mos mbaj mërzit askush s'të harroi kur ike nga ne fëmijët janë rritë plot me hijeshi çdo ditë të kujtojnë që kur ti i le.

Edhe ty të duan siç duhet një nanë dhe sa të jenë gjallë jo nuk të harrojnë aq sa është qielli i lartë dhe i gjanë aq mendojnë për ty, aq shpesh të kujtojnë.

Dhe një psherëtimë sikur del nga varri edhe kryqi krahët sikur i bashkoi përsëri hana rrugën e saj mori varrin dhe më shumë sikur e ndriçoi.

Thonë se për çdo natë atje lart në kodër rrugën e ndal hëna dhe me dikë seç flet thonë se merr ca fjalë nga 3 fëmijë në Shkodër dhe i çon tek varri i nanës së vet.

Luigj Mila
30 gusht 2007



SHABAN GJEKAJ, BILBILI I KËNGËS POPULLORE ULQINAKE

“Tujë iu ngjit Bunës përpjetë” është një ndër këngët më të njohura që Shaban Gjekaj me interpretimin e tij brilant e ka përjetësuar në fondin e artë të këngës popullore qytetare. Kjo këngë është ilustrimi më i mirë për të shpjeguar lidhjet e vjetra kulturore e zakonore të dy qyteteve, Ulqinit e Shkodrës që natyrshëm banorët e këtyre anëve i quajnë vëlla e motër. Buna, ky lumë legjendar, i qetë e i lundrueshëm që buron në zemër të Shkodrës ka përkundur në ujërat e veta, jo vetëm varka, sule e galera me mallra, por edhe shkodranë e ulqinakë që kanë bartur me vete atë që mund ta quajmë “mall shpirtëror” kulturën e ndërsjellët, traditën, zakonet, këngët e baladat.

Në këtë truall kulturor lindi dhe u rrit edhe Shaban Gjekaj, ky përfaqësues e përçues kulturor bashkëkohor i këngës popullore qytetare dhe në përgjithësi asaj shqiptare të trevave të Veriut. Ai, që në fëmëni, u përkund me këngët e vjetra ulqinake, me këngët e detarëve me zë, me vallet e këndueme të peshkatarëve ulqinakë për t’u njohur më vonë me “ariet” e mrekullueshme shkodrane, me interpretimet e pavdekshme të Bik Ndojës, Marije Krajës, Luçije Milotit, Xhevdet Hafizit, Shyqyri Alushit e shumë e shumë të tjerëve .

Kohën kur Shabani kishte arritur pjekuri në e tij artistike, e kushtëzonte politikisht ndarja dhe izolimi ndërshtetëror, por Buna Plakë shkonte teposhtë dhe ngitej përpjetë duke mbajtur të gjallë lidhjet e vjetra.

Shabani bashkë me Ulqinin e tij, u bënë “arkiva” e ruajtjes, regjistrimit dhe trashëgimisë së pasurisë folklorike të Anës së Malit. Bilbili i Ulqinit, kështu e quajnë këngëtarin e mirënjohur Shaban Gjekaj me 47 vite karrierë në skenë dhe ekran.

Shaban Gjekaj ka lindur më 1948 në Selitë të Ulqinit. Pasi përfundoi shkollën fillore në vendlindje dhe shkollën e mesme në Prishtinë, mbaroi studimet për fizikë dhe kimi në vitin ‘69 në filialin e Universitetit të Prishtinës në Prizren. Shabani voli këngën popullore të Anës së Malit që ishte si urë lidhëse mes Ulqinit dhe Shkodrës, trevë ku kanë lindur këngë e balada të vjetra, perla të muzikës shqiptare, ku gërshe-tohen trimëria dhe dashuria, të cilat, falë talentit të tij i përvetësoi dhe interpretoi që në moshë të re.

Shaban Gjekaj ka lëvruar këngët më të bukura të këngëtarëve të shquar shkodranë me të cilat është rritur, duke dëgjuar në atë kohë, Radio Shkodrën dhe Radio Tiranën, në vitet e para të karrierës së tij, të cilat ishin të vetmet burime kryesore të atyre viteve, por edhe arsimimi i Shabanit, edukata muzikore dhe përvoja e këngëtarëve të Kosovës, e vendosën Shabanin në shtegun nga ku nis karriera e tij artistike.

Talenti, zëri i tij i mrekullueshëm, rritja me këngën ulqinake e shkodrane, arsimimi në Kosovë mes shqiptarësh, formuan portretin dhe personalitetin e tij artistik, për ta bërë kështu të njohur në gjithë botën shqiptare. Ky burrë i pashëm ulqinak, me një portret rrëzëllues, sqimatar e xhentëlmen shpejt pushtoi skenat, ekranet dhe studiot radiofonike, me një pikësynim të veçantë: këngën shqip.

Kështu, shumë shpejt, në vitet ‘70, Shabani nuk ishte vetëm përfaqësuesi më i njohur i këngës dhe melosit ulqinak e shkodran në botën shqiptare, por ai u bë edhe ambasador i këngës shqiptare në ish Jugo-

sllavi.

Për një kohë relativisht të gjatë mbi 37 vite, Shaban Gjekaj punoi në arsim dhe së fundi drejtor i Qendrës Kulturore në Ulqin, deri në vitin 2011.

Gjatë kësaj karriere, rreth viteve ‘70-80 ai ka kënduar rregullisht në emisionet që Radio Titogradi transmetonte në gjuhën shqipe, duke filluar emisioni me këngët e Shaban Gjekës. Po në këtë periudhë, fillon edhe transmetimi në televizionin e Malit të Zi. Në emisionin “Mozaik” që jepej në gjuhën shqipe, me redaktor Fran Camaj dhe Zef Gjurarçaj me regjisor Hisen Bato Dukaj, protagonist ishte Shabani.

Nisur nga talenti, vullneti, dëshira dhe pasioni që Shaban Gjekaj kishte për këngën popullore qytetare, si dhe duke parë ecurinë e tij të suksesshme, një mik i Shabanit nga Tivari, Avdyl Zaganjori, në vitin ‘71 i dhuroi katër kasete me Aheng shkodran.

Moment tjetër i rëndësishëm që duhet evidentuar është edhe fakti që Shabani u pranua natyrshëm në RT e Prishtinës, duke u bërë këngëtar i mirënjohur i kohës për interpretimin burimor të këngës popullore.

Janë vitet ‘90 kur, edhe pse nuk u hapen kufijtë shtetërorë, u shembën ato gardhiqe të përkohshme kulturore e tradicionale, që për dekada me radhë i ndanë shqiptarët nga njëri-tjetri. Shkojnë e vijnë këngëtarë e artistë shkodranë e ulqinakë për të rikthyer atë miqësi e bashkëpunim të vjetër që kanë pasur me shekuj.

Pas mbylljes së RTP, në vitin ‘90, Shaban Gjekaj vazhdoi karrieren e tij duke realizuar inçizimet në produksione dhe studio të ndryshme në Ulqin, Tuz, Shkodër dhe Tiranë, të cilat janë në rrjedhën e krijimtarisë së tij të suksesshme, duke i qëndruar besnik jo vetëm traditës, por edhe kohës. Sukseset e Shaban Gjekës vijnë edhe me krijimtarinë si autor. Ai krijoi këngë të reja, të cilat shumë shpejt u përvetësuan nga populli, sidomos këngët “Shestanesha” dhe “Oj Rumia kësulëbardhë” që bartën jehonë motivuese të ruajtjes dhe kultivimit të vetëdijes patriotike dhe kombëtare në një zonë e cila kish filluar t’i jepej interpretimit dhe ndikimit të këngës sllave. Shabani, këngën ulqinake e këndon pa e deformuar, pra ashtu siç është kënduar para 100-200 vitesh, ku mund të përmenden “Ulqinaku n’ derë t’ dugajës”, “Moj Mejremja e Kadri Mehmetit”, “Kadife moj kadife” e shumë e shumë tjera si këto.

Në karrierën e Shabanit një vend sa të rëndësishëm, aq dhe të suksesshëm zë edhe vajza e tij Ermelinda Gjekaj-Ali, me të cilën ka kënduar në vitet ‘90-’93 në televizionin e Malit të Zi, në programet e vitit të ri, si dhe në festivalin folklorik mbarëkombëtar në Tiranë, Shabani me këngën e “Mujo Ulqinakut”, ndërsa vajza e tij Ermelinda me këngën “O moj ulqinake”, të kompozuar nga Fiqiri Hasanaga. Në këtë festival Ermerlinda, e bukur dhe e lirë si një fëllanxë mali apo si një sirenë deti me veshje karakteristike shestaneshe, por edhe me zërin e saj të ëmbël solli përpara spektatorit shqiptar pasurinë e këngës popullore ulqinake duke korrur një sukses të merituar, si përfaqësuese e një brezi më të

ri dhe si garantuese e vazhdimësisë së kësaj pasurie.

Aspak më poshtë nuk radhitet edhe djali i saj Muhamet Ali, i cili aktivizohet në Hollywood, si një aktor i ri me të ardhme të madhe. Ai ka luajtur role kryesore në disa prej filmave për fëmijë që paraqiten në kanalet



kryesore televizive siç janë: Nickelodeon dhe Disney XD. Gjithashtu u paraqit me sukses edhe në disa filma që u paraqitën në Sundance Film Festival. Performancat e këtij djaloshi në disa spote muzikore si aktor i ftuar special kanë qenë mbresëlënëse.

Kështu, këta interpretime të nipit plotësojnë më së miri trinomin e trashëgimisë artistike të një familjeje të mirëfilltë shqiptare që ruan të shenjta edhe vlerat kombëtare.

Shaban Gjekaj me repertorin e tij të larmishëm ka lënë gjurmë të pashlyera në interpretimin me mjeshtri të këngës popullore patriotike dhe qytetare, si kënga e “Dedë Gjo’ Lutit”, “Trinka e Grudës”, “Çun Mula”, (këngë të cilën e ka kënduar i pari), “Lufta e Zharnicës”, “Gjithçka shtrihen n’troje tona” me tekst të rapsodit Sali Mani dhe muzika nga Sokol Vulaj, “Për Kosovë s’më dhimbet shpirti” me tekst të Ibrahim Barjashit dhe muzika nga Nikollë Nikprelaj, “O bylbyl more këngëtar”, të cilën për herë të parë e ka kënduar këngëtarja Caje Poleshi, si dhe shumë këngë tjera të cilat kanë qenë të suksesshme pas viteve ‘80.

Z. Shaban, ju keni dhënë një kontribut të çmuar në ruajtjen dhe afrimin e këngës tradicionale qytetare ulqinake dhe shkodrane. Asnjëherë nuk jeni shkëputur prej tyre, duke mos harruar edhe viset e tjera shqiptare. Si filloj karriera juaj artistike si këngëtar popullor?

Karriera ime muzikore e mirëfilltë filloi në Prizren, në Shoqërinë Kulturore Artistike “Agimi” në vitin ‘68, duke u mirëpritur me shumë sukses në turnetë që organizoheshin në të gjitha qytetet e Kosovës. Rreth viteve ‘70 deri në ditët e sotme vazhdoj të këndoij dhe të kontribuoj në qytetin e Ulqinit, por pa e shkëputur bashkëpunimin me RTP dhe Shoqërinë Kulturore Artistike “Agimi” në Prizren.

Cilat ishin këngët që me zërin dhe interpretimin tuaj ju bënë shumë të njohur dhe të dashur për publikun?

Po, ata janë shumë, por unë do të veçoja sidomos këngët: “Krisi topi”, “Ali Pashë Te-

pelena”, “Tuj u ngjitë Bunës përpjetë”, due-ti me këngëtarin Lajde Berisha me këngën “Ma ke gishtin për unazë” dhe due-ti tjetër me këngëtarin Muhamet Jetishi me këngën “Drandofilja lypte hije”.

Çfarë ndodhi në vitin ‘68 pas suksesit që patët si këngëtar i talentuar?

Menjëherë erdhën ftesa nga redaktorë, producentë dhe kompozitorë të radios dhe televizionit të Prishtinës, përkatësisht nga z. Lorenc Antoni, redaktor, kompozitor i njohur dhe ndër studiuesit më të mirë të folklorit në Kosovë, duke mos e limituar kohën e inçizimit, por të regjistrojta sa më shumë këngë të vjetra ulqinake dhe shkodrane me orkestrën e Radio Televizionit të Prishtinës, që drejtohej nga mjeshtri Isak Muçolli.

Na tregoni diçka rreth turneve që keni patur në periudhën tuaj artistike kaq të larmishme.

Në vitet ‘78-’79 kam qenë në dy turne në SHBA, Kanada, Australi e në shumë vende të tjera në troje shqiptare, me estradën e ish-Jugosllavisë, me këngëtarët më të afirmuar të asaj kohe, si: Shaban Shuliq, Meho Puziq, Ismet Kërciq, Olivera Katania, etj.

Në vitin ‘79 për herë të parë vjen në Shkodër Ansambli i Ulqinit, ku u mirëpritë me këngën “Zaganjorja” dhe ky ansambël u përfaqësua edhe me vallen e “Peshkatarëve”, duke dhënë shfaqje edhe në Tiranë Pukë, etj.

Në vitin ‘80 mora pjesë në një turne në të gjitha qytetet e Shqipërisë, me Ansamblin e RTP, me gjeneratën më të artë të këngëtarëve të asaj kohe: Esat Bicurri, Ismet Bogujevci, Nazmie Hoxha, Luan Hajro, Nyzafete Shala, Faton Bakolli, Hanife Reçani nga Gostivari, etj, i cili mbetet për mua si një nga turnetë e paharruar.

Me cilët nga kompozitorë dhe poetë keni pasur bashkëpunime?

Kompozitorët dhe poetët me të cilët kam bashkëpunuar janë shumë. Mund të veçoj disa prej tyre, ato të Malit të Zi; Nikollë Nikprelaj, Sokol Vulaj, Shefko Dabi, Afrim Çoba, Gëzim Haxhimehmeti, me rapsodin e paharruar të Malësisë së Madhe Sali Mani, si dhe bashkpunimi me “Zëri i Kosovës”, “Fenix” në Tiranë, “Art klub” Ulqin etj, por pa u shkëputur edhe nga kompozitorët e mirënjohur të Kosovës Isak Muçolli dhe Isa Jakupi. Më pas vjen bashkëpunimi me kompozitorët më në zë të qytetit të Shkodrës dhe që ka qenë shumë i suksesshëm si: Pjetër Gaci, Zef Çoba, Nazmi Lishi, Luan Barova, Shpëtim Saraçi, Ilir Zoga etj. Të suksesshme kanë qenë edhe bashkëpunimet me autorët e teksteve si: Brahim Berjashi, Asllan Bisha, Haxhi Shabani, Basri Çapriqi, Bujar Ferhati, Gëzim Uruçi, Zyni Beqiraj etj.

Z. Shaban, cilat janë orkestrat me të cilat keni punuar gjatë përvojës tuaj 47 vjeçare dhe me të cilat keni patur edhe suksese?

Kam punuar me disa orkestra profesionale të mirënjohura si: Orkestra e Shoqërisë Kulturore “Agimi”, orkestra e Radiotelevizionit të Prishtinës, orkestra e Shoqërisë Kulturore “Buna”, orkestra “Dasma e Ulqinit”, orkestra e Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Tiranë, si dhe me orkestrën e kompozitorit të mirënjohur Agim Krajka në SHBA. Por kujtime të pa-

harruara dhe mbresëlënëse, janë edhe ato momente kur kam kënduar së bashku me këngëtaresh Parashqevi Simaku.

Dhe tani të vijmë në një moment që nuk është thjesht statistikë, por tregues i karrierës suaj dhe mirëpritjes që ke pasur nga publiku. Sa këngë pra keni të regjistruara në radio dhe televizione?

Që nga viti 1968 deri në vitet '90 inçizova rreth 80 këngë, ku 13 prej tyre në vitin '71 u inçizuan me orkestrën "Dasma e Ulqinit", kur dhe dolën edhe albumet e para (në pllaka gramafoni në atë kohë) me këngët "Ç'ka kalaja", "Kush po vjen me temena", "Mori kullë", "Me jelek me bar-navekë" e të tjera që tani edhe nuk më kujtohen.

Sa koncerte keni realizuar gjatë karrierës tuaj artistike?

Po, kam realizuar shumë koncerte në televizione të ndryshme si me RTSH, RTP, etj. të drejtuar nga regjisorët më të njohur në Shqipëri e Kosovë si: Ylli Pepo, Leonard Gjata, Gjergj Rita, Osman Mula, Vera Grabocka, Arjan Çuliqi, dhe me ato të Kosovës me producentin Musa Tolaj, me regjisorin Nuh Matoshi dhe drejtorin gjeneral të RTP, Osman Gashi etj.

Kam realizuar edhe disa koncerte recitale ku do të veçoja atë në Teatrin "Migjeni", në vitin 2001, në 35 vjetorin e karrierës sime artistike, me një sukses të jashtëzakonshëm, me orkestren e Shkodrës shoqëruar nga fizarmonicisti im Fiço Dabi, ku salla ka qenë e tejmbushur. Në këtë eveniment jam shoqëruar nga grupi folklorik "Zana" i Ulqinit, me udhëheqës artistik kompozitorin Nazmi Lishi, koreograf Kabil Mehmeti dhe moderatore Silvana Braçe. Mikpritja e spektatorit shkodran ishte jo vetëm treguesi më i mirë i lidhjeve të vjetra Shkodër-Ulqin, por edhe i pjekurisë sime si artist i këngës dhe interpretimit. Ai koncert nuk do të më shqitet kurrë nga mendja.

A keni patur kolegë tuaj të ftuar në këtë përvjetor?

Po, shumë. Të ftuar specialë kanë qenë kolegët e mi të nderuar këngëtarët Vjola Zefi dhe Bashkim Alibali. Kam realizuar edhe një recital tjetër me "Jehona e Shkodrës" me producent Xhelal Halili, në vitin

2001 me orkestren e drejtuar nga fizarmonicisti shkodran Qemal Kajushi, si dhe fizarmonicisti nga Mali i Zi Fiço Dabi.

Duhet të kujtoj edhe diçka...me Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve në Tiranë kam dhënë tre koncerte me këngëtarët më të njohur shkodranë si Xhevdet Hafizi, Shyqyri Alushi, Naile Hoxha, Hysen Koçia, Bujar Qamili, Bashkim Alibali, Mukades Çanga etj. Po me Ansamblin Shtetëror, në vitin 2004, kam dhënë një koncert ku ishin të pranishëm edhe këngëtarët Bujar Qamili dhe Elisabeta Marku, dhe që arriti një sukses të jashtëzakonshëm në Pallatin e Kulturës në Tiranë.

Na thoni diçka rreth pjesmarrjes tuaj në festivale dhe çmimet që keni marrë gjatë karrierës tuaj 47 vjeçare.

Jam pjesmarrës i disa festivaleve ku jam vlerësuar me çmime të ndryshme. Në vitin '69 si "Interpretuesi më i mirë" në "Akor-det e Kosovës" kur isha 21 vjeç me këngët "Shkollares fshatare" dhe "Pse ul' kryet kur n'rrugë t'takoj" të kompozitorit Isak Muçolli. Në "Fest Federativ" në Vranë Banja në vitin '71, në ish Republikën Federative Jugosllave, fitova çmimin e parë me duetin "Këndon bylbyli poshtë te zalli" me Gëzime Hajrullahun nga Tetova, si përfaqësues i RTP dhe "Rilindjes" ku çdo Republikë përfaqësohej me nga një këngëtar.

Në vitin '71 fitova "Çmimin e dytë të jurisë" me këngën "Lulja e këputur", përsëri në "Akordet e Kosovës" në Prishtinë, pas këngëtares së madhe Nexhmie Pagarusha, e cila fitoi çmimin e parë. E quaj një nder të madh këtë vlerësim pas këngëtares së paarrtshme Pagarusha. Po në vitin '71 në Festivalin e Zërit të Ri të Jugosllavisë që shtrihej nga Vardari shqiptar e deri te Alpet e Sllovenisë, zura vendin e parë duke interpretuar një duet të kënduar nga Ibrahim Tukeqi dhe Luçie Miloti "Këndon bilbili poshtë te zalli", një këngë kjo e Shqipërisë së izoluar që ngjitej në skenën e artit jugosllav, dhe që dëgjohej me frikë nga shqiptarët e Ulqinit.

Edhe në Detroit në SHBA në vitin '78, me orkestren e RTV të Beogradit me drejtues artistik Branimir Gjokiq, i shoqëruar dhe nga dy muzikantë shqiptarë në Neë York,

vllazërit Mehmeti, "Shoqata Besa" më dhuruan një "Paher".

Në festivalin e dytë mbarkombëtar të këngës kushtuar Kosovës, i organizuar nga Shoqata Atdhetare Kulturore "Kosova" e krijuar më 5 shkurt 1991 me President z.Dashamir Uruçi, organizatë e parë atdhetare kulturore për çështjen e Kosovës në Shqipëri, fitova "Çmimin e dytë të Jurisë" me këngën e "Mujo Ulqinakut" me tekst të Basri Çapriqit dhe muzikë të Nazmi Lishit. Në këtë festival morën pjesë këngëtarët më të mirë nga Kosova si: Ismet Peja, Esat Bicurri, Shpresa Gashi, Shkëlzen Jetishi, etj. me udhëheqës artistik Xhavit Ujkani.

Karriera juaj e gjatë nuk ka qenë thjesht një krenari për ju, por ka regjistruar në kredon tuaj artistike edhe emocine. Cilët janë pra disa nga momentet më të bukura dhe emocionuese që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme?

Emocionet më përshkojnë trupin edhe tani që po flasim. Një ndër momentet më të bukura dhe emocionuese për mua është kur kam kënduar për herë të parë këngën "Tuj u ngjit Bunës përjetë" në Tiranë. Këngëtar i Ansambilit Shtetëror të Tiranës Xhevdet Hafizi më dhuroi një buqetë me lule në Pallatin e Kulturës në Tiranë. E ndjeva veten shumë të nderuar, të vlerësuar e krenar që isha ulqinak dhe shqiptar. Por edhe një tjetër moment emocionues ka qenë kur jam nderuar dhe respektuar në Pallatin e Sportit në Shkodër, nga këngëtar i madh Shyqyri Alushi, i cili më dhuroi një tufë me lule, duke më falenderuar për zërin tim të bukur, pas interpretimit të këngës "N'Shkodrën tonë ka ra një dritë". Publiku në sallë u befusua nga që isha një djalosh i ri, mendoj i talentuar dhe që kisha zgjedhur për këtë publik një nga perlat muzikore që i kushtohet Shkodrës.

Nën autorësinë tuaj interpretative, siç e përmendët edhe më lart, ju keni shumë albume. Cilët nga këto, mendoni ju, se janë më të arriturit dhe që i kanë qëndruar kohës me këngë të cilat edhe sot këndohen me aq dashuri edhe nga brezat më të ri të këngëtarëve.

Në vitin '85 doli albumi në kasetë audio titulluar "Zaganjorja" me 10 këngë me

orkestren e RTP. Krijimtaria dhe prodhimtaria ime është e përmblodhur në 11 albume, duke arritur kështu një shifër të konsiderueshme prej rreth 180 këngë, ku në të cilat një pjesë janë edhe albume kolektive.

Bashkëbisedimit tim po i afrohet fundi dhe lexuesi është i ndërgjegjshëm se ky bashkëbisedim është vetëm një copëz nga veprimtaria juaj artistike. Ju vazhdoni të jetoni në Ulqin. Ende edhe sot zëri juaj dëgjohet në radio, tv, koncerte, festa, gëzime familjare, fejesa e dasma, sepse shpirti dhe kënga juaj nuk plakët. A mund të na thoni ndonjë nga ëndrrat tua të kahershme?

Ulqin-Shkodër vëlla e motër, njësoj janë, ska dallim, janë adete të njëjta, faktor ky, që nuk na ndanë. Një ëndërr e kahershme u bë zhgëndërr së fundi nga Bashkia e qytetit të Shkodrës, duke më vlerësuar me titullin: "Mirënjohja e Qytetit", me motivacion: "Për kontribut si përfaqësues tipik në interpretimin dhe afrimin e këngës tradicionale popullore ulqinake-shkodrane", sepse, siç e dini, jashtë kufijve të Shqipërisë nuk ka përçarur kush më shumë se unë këngët shkodrane.

A keni ndonjë falenderim apo mesazh për kolegët, bashkpunëtorët tuaj apo brezin më të ri të këngëtarëve?

Po. Në veçanti rreth këngëve popullore qytetare falenderoj kolegët e mi këngëtarë të vjetër dhe të rinj, por duke i porositur të rinjtë që këngët tradicionale të ruhen dhe të mos devijohen.

Cilat janë dëshirat dhe projektet tua të ardhmen?

Eh, shumë... dëshirat, planet dhe projektet e mia janë shumë, por do të veçoja realizimin e një recitali në Ulqin, Shkodër dhe Tiranë, si dhe botimin e një libri ku të përfshihen kujtimet nga karriera ime si këngëtar.

Ju falenderoj për bashkëbisedimin e ngrohtë!

Ju faleminderit juve!

*Bashkëbisedoi
RAMAZAN ÇEKA*

PLASTINA: "SKENDERBEU, UDHEHEQESI JUJ I MADH, ESHTË SHUMË I NJOHUR NE ITALI"

- BASHKEBISEDIM ME PRESIDENTIN E KLUBIT UNIVERSAL TE PAQES, PROF. FORTUNATO PLASTINA -

NGA ARBEN LAGRETA

Në këtë bashkëbisedim, Presidenti i Klubit Universal të Paqes, Profesor Fortunato Plastina flet me entuziazëm për impaktin pozitiv që tejcojnë këto klube paqeje kudo qofshin për promovimin e solidaritetit, komunikimit ndërmjet njerëzve pavarësisht besimit apo bindjeve politike si dhe paqen universal. Italian nga Kalabria, Prof. Plastina ndalet edhe në komunitetin arbëresh që jeton në këtë rajon të Italisë si dhe në njohjen shumë mirë të Skënderbeut në historinë e vendit

Në fillim do t'ju luteshim që të prezantohesni për publikun shqiptar në rajonin verior të Shqipërisë, si President i Klubit Universal të Paqes që drejtoni. Kush është Fortunato Plastina?

Po ju prezantohem pikë risht në pozicionin që cituat ju, pra në cilësinë e Presidentit të Klubit Universal të Paqes. (Universal Peace Club).

Si ju lindi ideja e krijimit të Klubit Uni-

versal të Paqes?

Klubi Universal i Paqes është krijuar 17 vjet më parë në Gjenevë dhe është një organizatë jofitimprurëse për të promovuar solidaritet, komunikim dhe paqe universale..Qëllimi ynë është për të promovuar paqen. Klubi synon që të rrisë ndërgjegjësimin e projektit të qendrës, organizimin e ditëve kulturore si takime, mbledhje me video-projektorë që promovojnë aktivitete kulturore si dhe materiale të tjera si shpërndarës kulturor për fëmijët.

Ku ndryshon sipas jush diplomacia e zakonshme në raport me diplomacinë që promovon Klubi Universal i Paqes?

Klubi Universal i Paqes nuk ka asnjë lidhje me diplomacinë ndërkombëtare. Po kështu në Klubin Universal të Paqes nuk ka asnjë diferencim ndërmjet religjioneve apo bindjeve të ndryshme politike.

Shqiperia është një vend ku lufrat dhe konfliktet kanë lënë gjurmë në ko-



shiençën e shqiptarëve. Po kështu edhe gjakmarrja, ndonjëse është reduktuar ekziston ende si fenomen, sidomos në Veri të vendit. Në këtë kontekst a mendoni që ta shtrini aktivitetin e Klubit Universal të Paqes që drejtoni edhe në Shqipëri?

Shqipëria është një vend i përshtatshëm për një Klub Universal të Paqes i cili do të shërbente si qendër e solidaritetit të komunikimit për një paqe universale. Me këtë Shqipëria do të ishte vendi promotor i paqes dhe mbi të gjitha, kjo do t'i sillte një zhvillim ekonomik përmes turistëve që do të vinin të vizitonin këtë simbol paqeje, deri tani kurrë të ndërtuar më parë. Dhe

mund të themi se Shqipëria do të kishte shumë nevojë.

Gjatë bisedës që bë më ju thatë se jeni nga Kalabria. Atje jetojnë prej shekujsh një komunitet shqiptarësh të larguar që nga koha e rënies së kalasë së fundit shqiptarë nën pushtimin oroman, asaj të Shkodrës që në Shqipëri quhen arbëreshë.

Skënderbeu, udhëheqësi i madh i shqiptarëve është shumë i njohur në Itali ku ka edhe shumë buste dhe monumente për nder të tij. Unë si kalabrez i Kozencës mund t'ju them se jam shumë i tërëruar nga historia juaj në të gjithë Kalabrinë. Në Kalabri ka vende ku flitet shqip, pra në gjuhën tuaj ose edhe me në shkrime të përkthyer në shqip sidomos në komunën e Kozencës. Një vend si Shqipëria me të kaluarën e saj mund të merret si shembull për botën për atë se jemi të gjithë vëllezër e motra. Sot më tepër se kurrë kemi nevojë për një Paqe Universale. Por nuk mjafton të flasim, duhet të reagojmë, mjaft me fjalë të bukura. Duhet të jemi solidarë dhe të bashkuar dhe kështu duhet që të ecim drejt një rruge e cila do të na çojë drejt respektit dhe solidaritetit universal. Ky është objektivi ynë. Do të jetë i gjatë por do t'ia arrijmë.

Vetëdemaskimi i një shoqërie pa autokontroll dhe kriminalizimi i të pafajshmit!

Ka jo shumë ditë nga ngjarja e rëndë e Urës së Shtrenjte, ku një vrasës si të gjithë vrasësit në botë, ju mori jetën dy turistëve çekë. Sot asnjë FB dhe asnjë gazetë, asnjë rrjet social, nuk merret me këtë gjë. E harruan fare, nuk kujtohet, është harruar dhe as që i bie kujt ndërmend se ka ndodhur gjë. Turistë çekë ka plot në Bregun e Lumit e rrugës së Prekalit dhe shumë prej tyre vendosin lule në vendin ku vdiqën bashkatdhetarët e tyre, por lule vendosin dhe shqiptarët. Malet dhe luginat me ujërat kristal vizitohen nga çekë e polakë, nga gjermanë dhe britanikë, nga amerikanë dhe unë takova dhe disa koreanojugorë sigurisht, të lumturuar dhe të qeshur sidomos nga trofta e Kirit lart?! E gjithë ngjarja kriminale ishte si të gjitha të tilla me turistët që janë me dhjetëra bie fjala në Itali, Francë, Spanjë, Greqi, dhe shumë e shumë vende sidomos turistiko malore. Por te ne, kjo ngjarje mori nga rrjetet sociale një vetëshkatërrim kombëtar idiot, pothuaj rrënues për racën dhe kombin. Po tregohej dhe demonstrohej në rrjetet dhe pastaj gazeta, urrejtja për veten në mënyrë sa të pëshitirë dhe idiote deri në përvërsitet. Nuk ishte thjesht keqardhje për turistët dhe urrejtje për një kriminel si të gjithë të tjetër, por një demulim për shqiptarin dhe malësorin, apo dhe krahinarin e atyshëm. Kishte një organizim për të dënuar aktin dhe kjo ishte shumë e mirë, por kishte dhe një marrëzi kolektive për të shkatërruar emrin e shqiptarit, moralin apo zakonet e tij. Kudo fjalë të tilla si “racë e poshtër, kriminelë të lindur, kështu jemi ne plehra, jemi një shtet kriminel, shqiptari është hajdut dhe vrasës, duhet të na largojnë nga Evropa thoshte njëri në FB dhe ishte alamet profesori burri i botës”?! Në fakt të gjithë e dinin, por dhe çekët vetë, se njerëzit e atyshëm janë personat më mikpritës që ka

si zakonisht veri-jugë Shqipëria. Kishin ndodhur grabitje të shëmtuara dhe vrasje makabre dhe në vendet e botës, dhe në Pragë vetë, por askush nuk shau dhe mallkoi racën e vet, se një kriminel që mund të ndodhë kudo vret turistë ose i grabit ato. As ambasada çeke dhe as qeveria e saj, nuk reaguesh ashpër, përkundrazi, treguan qartësisht se janë një qeveri dhe diplomaci për tu pasur zili. Çfarë ndodhi? As nuk ra numri turistëve dhe as nuk u abandonua turizmi sikundër shpreheshin një dorë gazetash dhe rrjetet sociale, (nuk duhet t’ju shkelë këmba ndër malokë shprehesh një këngëtare që zakonisht nuk këndon por nxjerr këmbët jashtë) përkundër, ai po lulëzon këto ditë në luginën e Prekalit dhe Bregun e Lumit apo Theth, Tamarë, Kelmend, Bogë dhe Razëm?! Absolutisht më mirë se çdo verë tjetër dhe nga të dhënat e para e gjithë malësia dhe Dukagjini kanë pasur mbi 60 000 turistë të huaj ditorë dhe më tepër ditë se kaq këtë verë. Rugët janë përmirësuar dhe hoteleria po ashtu, njerëzit janë shumë më të dashur dhe punë ka pasur plot. Vetëm në Theth kanë kaluar mbi 22 mijë turistë të huaj deri tani dhe ky është një tregues shumë i mirë në qoftë se shifrat janë të sakta dhe të referuara mirë. Gjithsesi ajo që mund të them është se edhe me vrasjen e poshtër dhe të ulët akoma jo të sqaruar se “pse realisht” të çekëve, turizmi nuk ra po u ngrit, dhe shkoi në nivelet më të larta sigurisht si rezultat i mikpritjes dhe kushteve dhe nga që u kuptua se vrasja ishte një rast vërtetë i izoluar. Po ashtu nga qeveria çeke, agjencitë, nuk u bënë politika që do të shënjonin largimin e turistëve çekë nga Thethi dhe malësia në përgjithësi. Dakord? Por dhe policia ishte dhe është shumë prezentë në zonë. Mirëpo çfarë ndodhi me shtypin çek? Sigurisht mbasi kaloi fati i vetëdemaskimit absurd të shq-

iptarit, nga shqiptarët në rrjete sociale dhe shtypin e përditshëm!? Katër ditë më parë mediati çeke botuan lajmin “bombë” se “një bandë me nëntë persona dhe mes tyre disa shqiptarë, kishin planifikuar rrëmbimin e djalit të ministrit të financave të Çekisë”. Të gjitha mediati e Pragës këtë gjë dhe lajmi i vërtetë ishte te “shqiptarët”, dhe jo te çekët si banditë?! Pra te shqiptarët që sigurisht ishin pastaj ato që “i jepnin më egërsi dhe më scoob si sharmë këtij lajmi, në shtypin dhe përgjithësi median çeke”?! Edhe te ne u bë një farë lajmi për këtë ... dalje nga Pragë, por askush nuk e çau kokën, sepse nuk ishte në Urën e Shtrenjte?! Hahaha ... çfarë apoteoze ... dhe idiotizmi adoleshent popullor! Në Pragë, gazetarët duhet të fusnin shqiptarë patjetër se “ju bënte lajm” dhe këtë zotësi e morën nga mediati tona, dhe rrjetet tona sociale, që “qurraviteshin” duke mallkuar racën e tyre, duke i bërë ato më kriminele se sa bie fjala vrasësit çekë apo italianë apo francezë apo gjermanë apo hungarezë apo serbë, apo spanjollë apo anglezë, apo shumë e shumë të tjerë?! Por dhe duke kërkuar ndjesë a thua se “kishin vrarë ata dhe jo kriminelin nga zona e Dukagjinit”?! Mungesë e madhe autokontrolli shoqëror, dhe një dëlir që tregon respektin e munguar për veten. Dje Z/Prokurorja e Pragës, Ivona Horska deklaroi se nuk ka shqiptarë në bandën me nëntë persona. Qartë? Nuk kishte kurrfarë shqiptari dhe e gjitha kjo ishte një shpikje e medias çeke për të implikuar shqiptarë patjetër në këtë rrëmbim dhe vjedhje, që duhet të ndodhte në vitin 2014!? I ishte bërë i qartë ky lajm si ambasadës tonë në Pragë dhe shtetit shqiptar. Pyetja tashmë është e prerë dhe shumë e dukshme se “pse media çeke i futi shqiptarët në lojë”? Përgjigja mund të jetë nga rasti i krimit në Ura e Shtrenjte dhe sidomos nga reagimi shkatërrues me fyerja ndaj vetes, e shitur si keqardhje për viktimat, e cila bëri të vetën. Është loja me autoviktimizimin e

pacientit të shpallur vetë si pa shërim, në një sëmundje shoqërore tonën, e cila ka për qëllim të përgjithësojë një veprim personal. Një sëmundje e shoqërisë tonë që bën namnin me të tilla gjepura “humanitare” dhe të ndjeshme. Ju duket sikur janë të civilizuar kur shajnë dhe shkatërrojnë racën dhe kombin, me të tilla profka, dhe me veprime që i kanë bërë më të rënda popujt shumë më të kulturuar se sa ne. Imagjinoni se në rrjetet mediatike përpara disa ditëve ishte marrë vesh se nuk kishte asnjë shqiptar, por thuhej se për vjedhjen e Ministrit banditët çekë ishin “instruktuar nga kriminelë shqiptar”?! E në përgjithësi po sigurohej se plani nuk kishte tone politike. Ja dhe njëri prej teksteve në çekisht që thotë pikërisht këtë gjë: Skupina zlocincu pochazela z. Albanie a tipy jim daval cesky spolupachatel. Botuar në http://krimi.eurozpravky.cz/ 128062-zlocinecky-gang-planoval-unos-babisova-ditete/ Sigurisht që çekët i kemi miq dhe turistë të shkëlqyer, por një sjellje e tillë me veten tonë, nuk na bën nder. Ne mund të respektojmë viktimat dhe dënojmë ashpër kriminelin, por nuk mund të rrënojmë veten tonë kështu. Kjo është sjellje prej “rajash” dhe një shoqërie akoma pa principe morale të rregulluara, por me një cilësi shumë jo civile, që është “miku mbi kokën tonë”? Kjo vlen në mikpritje “disi”, por jo në raport me të vërtetën dhe shoqërinë. Sepse kur ne flasim për vete kështu, “si mund të flasë një i huaj që diku i paska mbetur hatri nga një sjellje, apo dhe ushqim që nuk i ka pëlqyer në Shqipëri”? A mund të përgjithësohet kështu e keqa. Kurrën e kurrës, dhe akoma më shumë këtë gjë e kanë shumëar dhe cilësuar si të “vërtetë”, politikanët nga foltoret e tyre banale kudo që janë. Për një gjë krejt jo pjesë e shumicës, përgjithësohet e gjitha dhe e shumta. Kjo është një nga fatkeqësitë tona. E sigurisht është një turp.

Nga Besi BEKTESHI,
gazeta “SOT”, date 13 gusht 2015

Otomanët e periferisë që tentojnë të bëhen evropianët e periferisë?!

Nga Besi BEKTESHI
Nuk kam për qëllim aspak të bëj histori dhe as që dua t’ju bie në qafë si Osmanllinjve dhe pushtetit të tyre Ottoman, sepse për një histori perandorake të gjatë dhe të madhe, “opinonet” janë modele shumë të parëndësishme. Por ka diçka për ne, të rëndësishme në kohën kur ka ardhur dita e një shoqërie, e cila në brendësinë e saj gjithmonë analizon një fakt: Sa jemi me zemër perëndimorë dhe sa jemi me veprime ... unë them ... Ottoman, por nga ata të periferisë dhe jo të qendrës së Perandorisë Osmane. Tani mund të jetë edhe një “thashet-heme” apo trill gazetaresk, por Bismark për ne, apo shqiptarët e asaj kohe, e cila na mori toka dhe na vuri në lëvizje historike për pavarësi thoshte se, “janë turq mali”?! Dreqi e mori edhe unë fyhem sot e kësaj dite, por kishte dy arsye të mëdha. E para, ishim më shumë se të gjithë ballkanasit malësorë, pra jetonim në mal, dhe e dyta, më me rëndësi, nuk ishim “fushe” pra turq urban, por mali?! Është e rëndë, por e vërtetë edhe për “model të sundimit Osman”, se shqiptarët nuk shkruanin gjuhën e tyre, dhe nuk kishin një model drejtimi të qartë shqiptar?! Kjo sigurisht është e rëndë, kur të gjithë ballkanikët e tjerë, kishin përfutur pavarësitë nga Perandoria e Madhe Osmane apo pushteti Ottoman. Më duhet të sqaroj diçka! Osmanizmi nuk është lloj pushteti, është trashëgimi perandorake apo sulltanët e trashëgueshëm nga dera e madhe e Osmanëve, por Osmanët vijuan nga Ottomanët, të cilët të parin e kishin “Osman” dhe është sinjifikimi i pushtetërimit dhe zgjerimit të turqve të tillë! Ishte Osman Gazi, luftëtari turk i dinastisë Ottomane dhe prandaj normalisht që unë regjimit i them Otoman dhe modeli po ashtu, por kuptohet se trashëgimia është Osmanlije. Kjo perandori

zgjati nga 1299-1922 dhe ne ishin pjesë e saj që nga dorëzimi i kalasë së madhe të Shkodrës në vitin 1479-të dhe mund të them shpalljen e pavarësisë në vitin 1912. Por si ushtri, fundi ka qenë në maj të vitit 1913, kur Trupa e Internacionalit largoi nga Shkodra dy pushtime, atë pesë shekuj të Osmanëve dhe atë një muajsh të Malazezëve. Nuk po zgjatem, sepse ne ishim periferia e perandorisë Osmane dhe regjimit Ottoman?! Normalisht që pjesë e madhe e korifenjve të patriotizmit tonë dhe sigurisht Naim Frashëri apo Vaso Pasha, ishin të mrekulluar me perëndimin, por vetëdijen e merrnin nga Stambolli. Po ashtu Abdyl Frashëri dhe vetë Ismail Bej Vlora. Fan Noli vetë, ishte i lindur akoma më në lindje tonën, por më afër qendrës së Perandorisë dhe sigurisht iluminizmin shqiptar fillonte shpesh herë jo vetëm nga perëndimi, por dhe nga Stambolli vetë. Ju kujtohet “Shoqëria e Stambollit”?! Çfarë dua të them? Porta dhe Osmanllinjët, por dhe regjimi apo pushteti Ottoman, nuk janë interesuar shumë për periferinë e tyre afër Adriatikut?! Shqiptarëve nuk ju investuan as rrugë, as ura dhe as qendra urbane të qëndrueshme dhe të mëdha. Shqiptarët, çfarë kanë ngritur, i kanë bërë vetë dhe sidomos ne kohën e dy pashalëqeve të mëdha. Por Ottomanët kanë bërë një diçka tjetër shumë të keqe dhe në krahasim me popujt ortodoksë si grekët, serbët dhe bullgarët, malazezët dhe maqedonasit, sepse ju kanë lejuar shkrim dhe këndim, kurse shqiptarëve jo, dhe këtë e kanë bërë pothuaj deri në fund të qëndrimit si Ottoman-Osmanllinj dhe akoma më ashpër, duke dashur dhe të çarmatosin me Turqit e Rinj, të cilët u sollën akoma më keq se fundi i perandorisë ose Abdul Hamidi II. Shqiptarët kishin individë që drejtonin diku, por aspak shqiptarë të vetëqeverisur dhe me

vulat e firmat e tyre e në gjuhën e burokracinë e tyre. Ne ishin “Ottomanët” e periferisë, ose asaj perandorie të madhe që mezi mbahej në këmbë, por që ishin rrumpallë akoma më keq se sa vetë “Perandoria Rrumpallë” e kohës së fundit?! Të gjitha veset e saj si “ryshfeti”, “mashtrimi me letra e vula e firma”, “transformimi i pronës me letra dhe firma e vula”, “qyl-llëku dhe dembelizmi”, “thashethemnaje e zryave”: “çaji dhe kafa në punë”, “mungesa e orarit”, “spionllëku”, “servilizmi akut”, “kapadailëku inatçor”, që në qendër të Perandorisë kontrolloheshin disi dhe riparoheshin herë pas herë, në këtë vend, ishin lajtmotive dhe modele për tu ndjekur?! Ne ishin Ottomanët e periferisë, dhe lajmet që vinin si nga Parisi dhe Stambolli, donin kohë të vinin dhe jo më të aplikoheshin. Ne, periferikët Ottomanë, nuk ishin të fisëm. Ose më mirë, nuk kishin shkollim otoman të trashëgurar dhe nuk kishin shkolla fare, nuk kishin personalitete zyrtare në vend, pavarësisht të atyre jashtë apo vendet e perandorisë. Nuk lejuan asnjëherë ngritjen e një modeli qeverisës në vend Ottomanët pikërisht te shqiptarët. Më duhet të them se qeveria e Qemalit nga kjo gjë vuajti. Po ashtu dhe qeveria e mbas 1920-ës, prej këtij modeli vuajti. Mund të them se edhe kryengritjet apo modele të sundimtarëve prej këtij modeli Ottoman periferik i kemi pasur, dhe vijojmë ti kemi. Problemi jonë i madh është se çdo regjimi dhe sistemi, i shtojmë atë “Ottoman Periferik”, të jetuar më gjatë nga ne si popull dhe komb. Qeveritë e para 1920-28 kështu i trajtuam dhe pse ndaluan të shkolluarit e Turqisë të vinin. Po ashtu Monarkinë edhe pse tentonte nga perëndimi dhe kishte një dëshirë të tillë e mbyste veprimi “Ottoman Periferik”, i jetuar gjatë e gjatë nga shqiptarët. Çdo gjë e “mishelolin” me Ottomanizëm Periferik, dhe kështu e shijonin më mirë. Po ashtu dhe të ashtuqajturin Komunizëm, po kështu e trajtuan shqiptarët. Enveri vetë ishte më shumë Ottoman periferik se komunist, dhe për më tepër Gjio-kastra dhe disa qytete të thera të Shqipërisë

si Berati e Shkodra, po kështu ishin në themel të tyre?! Ishin qytete të bukur dhe veçantë, por në fakt, kultura e tyre ottomane periferike, bënë të qartë dhe karakterin. Megjithatë kjo “periferi Ottomane” jona, ka dhe diçka të mirë përveç të keqes që nuk të lë të jesh me “ADN” perëndimor?! Po ka të mirë, se nuk je as në themel tëndin me “ADN” Ottoman?! E këtu pastaj trajtohen gjërat dhe faktet historike me batutat “mes lindjes dhe perëndimit” po pikërisht mes dy qytetërimeve dhe modeleve të mëdha. Ishin mes krishterimit lindor dhe perëndimor dhe pastaj me perandorinë e re, u vet orientuam dhe për shkak të forcës, në një periferi Ottomane, por që gjithmonë diçka na joshte nga perëndimi. Tani kemi mbi 100-të vite, që duam të gjejmë drejtpeshim kombëtar dhe sidomos atë kulturor. Në fakt Ottomanizmi jonë kulturor edhe pse i dobët dhe jo me shkollim dhe trashëgimi të plotë, është inatçor dhe instiktiv, nuk ka ndryshim në se je mysliman, katolik, arthodoks apo bektashi?! Jo, nuk ka kurrfarë ndryshimi, sepse është si të thuash ... mentalitet. Ne jemi të gjithë njësoj kështu!? Në këtë pikë, më herët dhe më mirë e kanë marrë veten, “ottomanët” e qendrës, se sa ne të periferisë. Po sigurisht, sepse dhe atëherë ishin më mirë disi. Problemi është se as “ottoman” normal nuk u bë më, dhe as të qendrës jo e jo?! Por kur mbetëm të “periferisë” si nuk morëm vendim një herë të vetme të bëhemi “Evropian të Periferisë”... hahata ... sa për eufemizëm e them këtë. Po pra, të bëhemi “Evropian të Periferisë” dhe të provojmë në këtë drejtim. Por ka problem të madh kjo gjë, sepse sa po shkruaja artikullin shikoj Lulëzim Bashën që në shtëpinë e një viktime të vetëvarrë thoshte “shtet zuzar”?! Një “lider” që nuk kalon shumë 40-të vitet jetë dhe në vitin 2015 dhe thotë ... zuzar ... një fjalor pak të themi retro ottoman, pa i rënë në qafë pikërisht fjalorit të gjuhës shqipe?! Imagjinoni sa thellë është problemi!

*Marre nga gazeta “SOT”,
date 12 shtator 2015*

MARTIN CAMAJ – YNI APO I MËRGATËS?

PËR 90-VJETORIN E DITËLINDJES SË MARTIN CAMAJT

(vijon nga faqja 2)

Në të vetmen *Histori të letërsisë shqiptare* nga Robert Elsie (shqiptarët ende s'kanë shkruar një vepër përkatëse), Martin Camaj dhe Arshi Pipa figurojnë ndër emra si Xhevat Kallajxhi, Kosovë Rexha-Bala, Mustafa Hukluki, Nijazi Sulça etj. Ky kategorizim përvetësohet dhe nga penda të tjera. Me këtë, Camaj marginalizohet dhe, deri diku, përjashtohet nga rrjedha e letërsisë shqiptare. Askujt nuk do t'i binte ndër mend ta quajë Nolin a Konicën autorë "të diasporës", "të mërgatës" a "të ekzilit". Kategorizimi i Martin Camajt si autor "i mërgatës" etj., bëhet për shkakun thjesht biografik d.m.th. jolettrar.

Nëse Camaj nuk bën pjesë ndër shkrimtarët që "ne i kemi nxjerrë", do



të ishte e logjikshme të thuhet se atë e ka nxjerrë mërgata, diaspora, ekzili. Gjë absurde! Shkrimtarin Martin Camaj nuk e nxori diaspora, mërgata a ekzili, por tradita e letërsisë shqiptare dhe thesari i traditave gojore të Shqipërisë së Veriut. Në krijimtarinë e Martin Camajt nuk gjenden elementet tipike të shkrimtarëve të mërgatës a ekzilit. Ata zakonisht mer-



ren qoftë me letërsi sentimentale patriotike që e idilizon dhe glorifikon atdheun, qoftë me letërsi të politizuar që e akuzon vendlindjen dhe rrethanat politike në të. Autorë të tillë zakonisht merren edhe me shkrime gazetareske që e damkosin sistemin diktatorial në vendlindje. Ndryshe nga ata, shkrimtari Camaj shkroi me këmbëngulje letërsi, letërsi të mirëfilltë dhe

asgjë tjetër. Ai është një autor i letërsisë shqiptare në kohën e diktaturës komuniste, një nonkonformist për nga stili e estetika dhe për nga përmbajtja e veprës së tij, një shkrimtar jashtë kornizave të letërsisë zyrtare të kohës, por jo jashtë kornizave të letërsisë së Shqipërisë.

Në vitin e fundit të jetës, më 1992-shin, ai tha në një mesazh për shqiptarët se "unë jam i jueji dhe ju jeni të mijt". Ka ardhur koha që të mendohet në Shqipëri se "Martin Camaj është yni".

Marrë nga *Gazeta Shqip*,
21 Korrik 2015

VDIQ MARK KRASNIQI PISHTAR I MENDIMIT SHQIPTAR

Me vdekjen e Mark Krasniqit u shua një pishtar i mendimit shqiptar.

Letrat shqipe humbën një ikonë urtësie, mirësie dhe devocioni. Etnografia jonë humbi patriarkun flokëbardhë, gjeografia humbi komentarin autentik, publicistika, humbi stilistin shigjetues. Poezia humbi një vegim rrezellitës. Bota trëndafilore humbi poetin e ledhatimeve dhe gicilimeve të magjishme femnore. Politika humbi idealistin me profil perëndimor. Jeta Mark Krasniqit është refren marshesh të zjarra atdhetare.

Me aq pasion sa donte Kosovën, Shqipërinë, natyrën dhe visaret tona kombëtare, donte lirinë e munguar, çmonte demokracinë dhe progresin, së cilës ju përkushtua me mish e me shpirt. Emri i Mark Krasniqit u nde jo vetëm në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, por edhe në Ballkan e me më gjerë. Emri i qëndron në radhën mendjeve më të ndritura të shkencore, letrare dhe politike të botes shqiptare. Nikaj - Merturi që i fali genin, Peja që e lindi, Kosova që fisnikëroi, Shqipëria që pati birë kanë drejtë të ndihen krenar për këtë burrë të madh të atdheut. Baca Mark u shua fizikisht por shëmbëllimi i veprës së tij shkëlqen si dielli në majat qiell-prekëse të mendimit intelektual shqiptar.

BIOGRAFI E SHKURTER E AKADEMIK MARK KRASNIQI

Ka lindur në Gllaviçicë afër Pejës, me gjak atëror është i Nikaj, nga nena është nip Merturi (gjë të cilën e ka deklaruar kurdoherë, madje dhe në një publik si në festën madhe të Nikaj-Mërturit në



Tiranë, me 2010)

Shkollën fillore e vazhdoi në vendlindje, ndërsa gjimnazin në Prizren. Në vitet 1941-43 përfundoi Universitetin e Padovës për Letërsi.

Në vitin 1950 përfundon Universitetin e Beogradit, për Gjeografi- Etnografi.

Ka punuar si gazetarë dhe redaktori Rilindjes në redaksinë e emisioneve shqip në vitet 1967-1969. Gjatë viteve 50-61 ka punuar në Akademinë Serbe të Beogradit.

Në vitin 1960 doktorohet në UT Lubja-

nës. Në vitet 1960-1981 ka punuar Profesor në UT Prishtinës dhe disa herë Rektor i këtij institucioni.

Disa herë ka shërbyer dekan dhe prodekan i Fakultetit Juridik-Ekonomik, në Prishtinë. Gjithashtu, është ngarkuar me detyra të larta, si: zëvendëskryetar dhe kryetar i Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës, kryetar i parë i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës (1970) dhe kryetar i Partisë Shqiptare Demokratike të Kosovës (1993). Është anëtar i Akademisë së Shkencave e Arteve të

Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ka marrë pjesë dhe ka lexuar punime të tij në shumë kongrese, konferenca e simpoziume kombëtare e ndërkombëtare, ku janë diskutuar çështje të traditave, gjuhës letrare kombëtare, historisë, etnografisë, folklorit shqiptar e tjerë.

Ka botuar **libra shkencor**: "Ndryshimet gjeografike shoqërore në Kosovë e Dukagjin", 1960; "Gjurmë e gjurmime", 1979; "Lugu i Baranit", 1985; "Rugova", 1978; "Aspekte mitologjike", 1997. **Libra shkollor**: "Gjeografia ekonomike për shkollat e larta", 1958; "Gjeografia e Jugosllavisë- kl IV", 1984. Ka botuar **libra në vargje**: "Përrallat e gjyshes", 1958; "Dita e parë", 1956; "Jehona e kohës", 1973; "Postieri maleve", 1984; "Borbardha", 1985 dhe "Kulla e Babelit", 1989.

Akademik Mark Krasniqi ishte i pari Kryetarë i Partisë Demokratike të Kosovës, pas rënies së sistemit njëpartiak në Kosovë.

Mark Krasniqi është pa as një mëdyshje një nga figurat më të shquara të elitës shkencore të hapësirës mbarë-shqiptar.

Përgatiti **PREL Milani**

Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi

RËNIA E KALASË!

“Kur Sulltani nga çadra po sodiste bukurinë e Kalasë, tha: Oh çvend të bukur ka zgjedhur shqiponja për të rritur zogjtë e saj!”

Marin Barleti

Ti je Kalaja më e fortë mbi tokë!
Ti je Kalaja më e përgjakuna në botë!

Për ty shkodranët luftuan si luan,
Me në krye komandantin e madh Loredan!

Me gjak u skuqën, Buna dhe Drini!
Për ty luftoi dhe Lekë Dukagjini!

Për ty luftuan heroikisht shkodranët,
Për ty qëndruan burrërisht si Trojanët!

Shkodra atëbotë kish’ flotë dhe detarë,
Për të dhanë jetën 200 marinarë!

Në breg të liqenit, kantier ndërtimi
Ku ngriheshin anije, lufte e tregtimi ;

Që quheshin liburne, ose labeatë
Dhe çanin detrat në rrugën e gjatë

Kur vendi po digjej prej flakës së zjarrit,
Përballë topave të armik – barbarit
Mburojë u ngritën gjokset e shqiptarit!

+ Me turp u mund turku me forcat e tija
Për shkodranët e përjetshme mbeti Lavdia!

Kur hileja u kurdis mes turkut e Venedikut
Fatziu Atdhe ra në duart e armikut!

Gratë dhe fëmijët, duheshin larguar
Nga vendi ku kishin lindur, rritur e jetuar.

Dhe gratë sokolesha, që si burrat luftuan
Në duart e jeniçerëve të mjerat përfunduan!

Vendin e mbuloi zia dhe mjerimi
Fjalët s’ mjaftojnë të përshkruhet hidhërimi!

Ndue Mici

PROFESORI NUK ËSHTË MË

Patriotizmi është atdhe
Është nderi edhe lavdia,
Në këtë truall ne kemi le
Këtu i ka rrënjët liria.

Merr valixhet shpejt grue
Të nisemi sa më parë,
Na ndihmo Zot me shkue
Fati në derë na ka ardhë

Iku shpejt nga vendlindja
Për askënd s’iu bë vonë,
Komshisë së tij i vdiq fëmija
Edhe gruaja në operacion.

Ka pas thanë një farë burrit
Specialist dhe me përvojë:
Morto io morto tutti
Vetëm unë të shpëtoj.

Profesori nuk është ma
Nga klinika iku vjet,

Ai shkoj në Kanada
Të rregulloj b.... e vet.

Përpara o burra
“Ajka” e kombit tonë,
Ju ikët nga lufta
Ju paçim gjithmonë.

TRASHËGIM NA E LA BABA

Për këto pyje, livadhe, toka
Me brengë në zemër vdiq baba,
Ato janë porsi fëmija
Më besoni, u pastë halla.

Një okej prona private
Sa thellë je futur ti!
Si prushi t’ janë bërë faqet
Merr ilaçet ke zjarrmi!

Të lutem mbaj shënim
Kam një testament të artë,
M’ a ka lanë gjyshi im
Dhuratë nga “Porta e Lartë”

Che bella signora terra
Me nderim të falemi ty,
Ti je lulja, ti je ferra
Nëse mbyllim njërin sy.

Lum ai që nuk kurseu
Gjithë jetën fisnikëri,
Si margaritar e ruan dheu
Hiri i tij do jetë flori,

Luigj Temali



Majat e Shalës, 2015

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

